



Gjashtë shenjtorë bektashi të Fushë-bardhës

Nga: Zaho Golemi

fq. 12



Nga: Prof. Dr. Bardhosh Gaçe

“Epika e trimërisë së Zhulatit” dhe luftëtari Mersin Gjoca



fq. 11

Olimbi Dafa, rrëfen vetveten me vëllimin poetik “Fytyra e jetës”



Nga: Tomorr Kotorri

fq. 16



LABËRIA



Periodike e Pavarur

Viti i XXIV i botimit Nr.178 (382)

Gazetë e Shoqatës Kulturore-Atdhetare “Labëria”

Korrik 2024

Çmimi: 20 lekë/ 1 euro

Buronjat e Kuçit në festën e madhe

Nga Agim Çiraku - Kryetar i Shoqatës Labëria “Nderi i Kombit”

INTERVISTA

Flet piktori Astrit Beluli: Ekspozita vetjake “Labëria ime” i kaloi pritshmëritë

Intervistoi: Albert Z. ZHOLI



Astrit Beluli

Me Astritin kemi rreth 2 dekada miqësi. Jemi me origjinë nga Tepelena, por në Tiranë jemi komshi. Studio e tij është 50 metër larg shtëpisë sime dhe në atë studio mbledhen shumë tepelenas. Dhe pse në pension Astriti e hap studion në 06-30 në mëngjes dhe e mbyll në 22-00. Lëviz me biçikletë pasi këtë lëvizje e quan sportin më të shëndetshëm. Shoqërues gjithmonë ka “Pufin” një qen tekancos, por tepër i bukur dhe i zgjuar. Astriti i shërben qenit sikur ta ketë fëmijë. Me aq sa njoh unë miq e shok, këtë përkujdesje nuk e bëjmë as ndaj fëmijëve. Dhe Pufi krekoset kur kalon në “Don Bosko” pasi ka një “shërbëtor” besnik që ja plotëson tekat deri në detaj. Kushdij që kalon para studios së Astritit patjetër do të ndalojë disa momente për të shlodhur sytë me pikturat e Astritit. Piktura ku dominonin jeshilja, bluja dhe e verdha...

fq. 4-5



Agim Çiraku



SPECIALE

Kur vlerësohet njeriu i punës Nase Abazi



Nga: Ahmet Demaj

fq. 10

VËZHGIM

Labëria në Luftën e Vlorës




Nga: Albert Habazaj

fq. 7

SPECIALE

Kur ulem e shkruaj për Prof, Dr.Ago Nezha, “Mjeshtër i Madh”



Nga: Pandeli Bardhi

fq. 13

Mbasdite kujtese në “Art Hotel” për “Bilbilin e Labërisë”, Hyso Xhaferraj



Nga: Besnik Gjonbrataj

Rukën, Feti Brahimin, Nazif Çelën, Hyso Xhaferraj, Vendim Kapaj, ...

fq. 2

Në “Art Hotel”, krahas shumë pikturave pendoset piktura e “Bilbilit të Labërisë”, Hyso Xhaferraj. Po të vizitosh ambientet e Art Hotel në Tiranë, ajo që do të bjerë në sy, janë pikturat e shumta të piktorëve, kryesisht vlonjatë, por jo vetëm. E gjithë kjo falë vlonjatit Bujar Leskaj, të pasionuarit pas pikturave të vjetra, por edhe të kohës moderne edhe si një ish personalitet i lartë i artit e kulturës shqiptare për disa vite me radhë.

Përse ky aktivitet në Art Hotel?

Bujari, si dashamirës dhe mbështetës i polifonisë labe, kishte një njohje të veçantë me të gjithë këngëtarët e poetët e Labërisë si: Lefter Çipën, Petrit

MBASDITE KUJTESE NË “ART HOTEL” PËR “BILBILIN E LABËRISË”, HYSO XHAFERAJ

Hyso Xhaferaj dhe Lefter Çipa, Petrit Ruka, Feti Brahimi, Nazif Çela, Hyso Xhaferaj, Vendim Kapaj, Golik Likaj



Nga: Besnik Gjonbrataj

Në “Art Hotel”, krahas shumë pikturave vendoset piktura e “Bilbilin të Labërisë”, Hyso Xhaferaj. Po të vizitosh ambientet e Art Hotel në Tiranë, ajo që do të bjerë në sy, janë pikurat e shumta të piktorëve, kryesisht vlonjatë, por jo vetëm. E gjithë kjo falë vlonjatit Bujar Leskaj, të pasionuarit pas pikurave të vjetra, por edhe të kohës moderne edhe si një ish personalitet i lartë i artit e kulturës shqiptare për disa vite me radhë.

Përse ky aktivitet në Art Hotel?

Bujari, si dashamirës dhe mbështetës i polifonisë labe, kishte një njohje të veçantë me të gjithë këngëtarët e poetët e Labërisë si: Lefter Çipën, Petrit Rukën, Feti Brahimin, Nazif Çelën, Hyso Xhaferaj, Vendim Kapaj, Golik Likaj, etj. Hyson e vlerësonte shumë për zërin e veçantë, por edhe si njeri për humorin e hollë dhe si një njohës shumë i mirë i polifonisë, i zakoneve e traditave të Labërisë.

Bujari kishte një peng, sepse në ditën e ndarjes nga jeta të Hysos nuk ishte ndodhur në Shqipëri dhe si për ta hequr këtë peng, në vlerësim të figurës së Hysos, vuri në dispozicion ambientet e tij dhe bërjen e dy pikurave të portretit të Hysos, njërin duke ia shtuar koleksionit të tij të pikurave në ambientet e Art Hotel dhe tjetrën për t'ia dhuruar familjes.

Nga dje një vend të veçantë në morinë e pikurave zë edhe piktura e “Bilbilin të Labërisë” Hyso Xhaferaj. Portreti i Hysos qëndron, i vendosur mjaft bukur rrëzë malit të Bogonicës, që simbolizon qëndrueshmëri e popullit të Kallarait në shekuj për mbrojtjen e tij nga pushtuesit me forcën e pushkës si stërgjyshi i tij, dëshmori i vitit 1914, Hyso Balil Xhaferaj i Parë, ndërsa Hyso Balil Xhaferaj i Dytë, duke e lartësuar Kallaratin e tij të dashur me zërin e tij pushkë. Në ceremoninë tepër të thjeshtë, zhvilluar në mbrëmje përveç pjesëtarëve të familjes ishin të pranishëm: deputet, personalitete të artit, kulturës, shkencës, drejtues të shoqatës “Labëria” e shoqatës “Kallarati”, gazetarë, studiues të muzikës e folklorit, këngëtarë të Ansambllit të Këngëve e Valleve Popullore, por edhe të grupeve të Labërisë si: deputeti Laert Duraj, profesorët Bardhosh Gaçe e Rami Memushaj, aktori Bujar Asqeriu “Nderi i Kombit”, gazetarët Aleksandër Çipa e Albert Zholi, këngëtarët e labërisë:

Nazif Çela e Vendim Kapaj “Mjeshtrit e Mëdhenj”, këngëtarit i ansambllit shtetëror të Këngëve dhe Valleve Popullore Lek Pecnikaj, këngëtarit kallaratas Gjergji Leskaj, Gramoz Xhaferaj, djali i Hysos Alvaro Xhaferaj, etj.

Aktiviteti nisi me një video të shkurtër, realizuar nga Besnik Gjonbrataj sipas një interviste me zë, bërë në vitin 2016, por e papublikuar më parë. Në fjalët e Hysos, nëpërmjet së cilave shpreheshin vlerësime me shpirt e me zemër për bashkëfshatarët e tij kallaratas me të cilët u rrit e këndoi përkrah tyre, për drejtuesit dhe personalitetet e muzikës, artit e kulturës shqiptare, të cilët e ndihmuan të shpaloste



talentin e tij të këngës në institucionin më të lartë, pikërisht në Ansambllin Shtetëror të Këngëve dhe Valleve Popullore, për shokët, miqtë e kolegët me të cilët ai këndoi në këtë pjesë të jetës edhe pse të shkurtër, do të shërbenin si një amanet i tij, pasi jeta dhe kënga iu ndërpre në mes, në kulmin e pjekurisë së tij artistike.

Më pas fjalën në emër të shoqatës Kallarati, por edhe të grupit organizator e mori z. Besnik Gjonbrataj, i cili falënderoi pjesëmarrësit për praninë e tyre, ardhur në këtë mbasdite kujtese, si miq e shokë të Hysos e të familjes së tij dhe z. Bujar Leskaj për organizimin e këtij eventi në ambientet e tij private të Art Hotel - ndërmyet të

Piktura me portretin e Hysos iu dorëzua vëllait, Bakos e djalit Alvaros nga z. Bujar Leskaj, i cili në fjalën e tij e cilësoi Hyson “Artist të përmasave e vlerave të mëdha të polifonisë labe”, i cili mbetet nderi dhe krenaria e Vlorës dhe e Shqipërisë.

tjerash u shpreh: “Mjaftë kuptimplotë tingëllojnë sot vargjet e këngës që Hyso vetë me shokë këndoi “Luanët një vdekje kanë”. Vërtet luanët, por edhe artistët si Hyso një vdekje kanë, por kënga e tyre nuk vdesë kurrë. Hyso do të rrojë, sa të rrojë vetë kënga, siç shprehet poeti Nexhip Onjeja në baladën kushtuar Hysos e interpretuar nga aktori Bujar Asqeriu “Nderi i Kombit”. Piktura me portretin e Hysos iu dorëzua vëllait, Bakos e djalit Alvaros nga z. Bujar Leskaj, i cili në fjalën e tij e cilësoi Hyson “Artist të përmasave e vlerave të mëdha të polifonisë labe”, i cili mbetet nderi dhe krenaria e Vlorës dhe e Shqipërisë. Surpriza e kësaj mbrëmje ishte krijimi më i fundit “Këngë vaj” i bërë enkas nga dy miqtë e shpirtit - siç shprehej Hyso - me të cilët këndoi kushedi sa këngë, dy “Mjeshtrit e Mëdhenj” Nazif Çela e Vendim Kapaj, e cila me melodinë e cjlës dyjare luajtur nga Vendimi e zërin e veçantë, melodioz e vajtues të Nazifit, sollën emocione të papara tek pjesëmarrësit.

Të gjithë pjesëmarrësit, si Prof. Dr. Bardhosh Gaçe, Prof. Dr. Rami Memushaj, gazetarit Aleksandër Çipa e Albert Zholi, deputeti Laert Duraj, këngëtarët Lek Pecnikaj, Nazif Çela e Vendim Kapaj, në fjalën e tyre sollën kujtime të pashlyeshme me Hyson, qoftë nëpërmjet këngës, apo edhe të bisedave me të, si dhe bënë vlerësime maksimale për figurën e tij si këngëtar i veçantë i polifonisë labe.

Bujar Asqeriu “Nderi i Kombit”, aktor: “E quaj veten me fat që kam njohur një artist të rrallë si Hyso Xhaferaj. Jo vetëm kam dëgjuar zërin e tij por kemi bashkëpunuar në disa projekte me të. Ai mua më shkatërronte me modestinë e tij. Nuk kam parë artist me aq talent të rrallë të dedikuar nga zoti e të ishte aq modest. Ai futej në skenë aq natyrshëm sikur ishte askushi dhe jo një artist me zë të rrallë. Ai nuk kishte vetëm zërin, kishte të zhvilluar mjaft edhe anën njerëzore e sidomos humorin. Kishe qejf ta dëgjoje kur fliste me një dashuri të paparë për këngën, për Labërinë, për Shqipërinë. Ai ishte konsultuar me “Mbretërit e Polifonisë”,



me të madhin Lefter Çipa, të cilin e kishte idhull. Hyso e kishte kuptuar që Lefteri ishte “Gjeni” dhe prandaj konsultohet me të. Ikën të dy, duke lënë pas poezitë e këngët e tyre” - përfundon Bujar Asqeriu.

Lek Pecnikaj, këngëtar i ansambllit: “Hyso dhe unë ishim shokë të ngushtë dhe kudo që shkonim në turne të ansambllit brenda e jashtë shtetit do të zinin të njëjtën dhomë hoteli. Edhe pse ai nga Vlora e unë Tropoja përveç këngës na bashkonte çiltërsia, besnikëria të burrëria. Shokët e tij ishin edhe shokët e mi. Nëpërmjet tij njoha edhe të madhin Lefter Çipa, “Nderi i Kombit”, idhullin e tij. Hyso kishte një zë të veçantë. Ai më mungon mua si shok, por i mungon edhe Ansambllit u mungon këngës labe, i mungon familjes, por kemi zërin e tij që nuk do ta harrojmë kurrë”

Prof. Dr. Rami Memushaj, gjuhëtar: “Hyso ishte talent i rrallë që i bënte nder Polifonisë Labe. Ai eci në gjurmët e të atit Bililit, por edhe të bashkëfshatarëve të tij Zeqos, Yzeirit, Hekuranit, Sulotes, Haires, Mjaftimes dhe trashëgoi çdo gjë të mirë prej tyre, duke e ngritur këngën labe në nivelet më të larta në përbërje të Ansambllit të Këngëve dhe Valleve Popullore. Si mbetet krenaria e Kallarait dhe i Labërisë”.

Aleksandër Çipa, gazetar: “Ky event dëshmon për respektin ndaj artistëve të mëdhenj si Hyso. Ikja e parakohshme nga jeta e Hysos, ishte një humbje e madhe shpirtërore edhe për familjen tonë, sepse Hyso ishte një mik i rrallë për të gjithë ne sidomos për Lefterin. Hyso shkonte në Pilur te Lefteri ndoshta më shumë se unë djali i tij. Po ashtu kur Lefteri vinte

në Tiranë më parë do të kërkonte Hyson se sa mua si djallë. Kaq shumë ishin të lidhur me njëri tjetrin. Ajo që i bashkonte ishte kënga labe. Te Hyso Lefteri shkonte një talent të jashtëzakonshëm të këngës labe, një njohës dhe mbrojtës të polifonisë labe. Me ata të dy nuk mund të bëje kompromise për këngën labe. Ikën të dy gati në të njëjtën kohë, duke lënë pas si trashëgimi “Polifoninë Labe” - siç me të drejtë e quante im at Lefteri. Qofshin të paharruar!

Prof. Dr. Bardhosh Gaçe, shkrimtar: “Hyson e kam njohur familjarisht shumë herët, biles në shtëpinë e tyre te xha Balili kam ngrënë bukë e pirë raki, se ishte shtëpi mikpritëse e me taban labërie. Hyson e vlerësonte shumë Llambro Hysi, Feti Brahimi, Muhamet Tartari, Avni Varfi, Kristo Çipa e mbi të gjitha i madhi Lefter Çipa si një këngëtar me zë të rrallë. Ky është Hyso i dytë - siç e kam shkruar edhe në librin “Enciklopedia e Vlorës”, pasi i Hyso i parë ishte ai i 1914-ës që dha jetën për mbrojtjen e fshatit nga andartët grekë. Lefter Çipa duke vlerësuar zërin e

Hysos do të shprehej: “A sikur t’a kisha gurmazin tënd në trupin tim”!. Njerëz të tillë si Hyso mbeten të pavdekshëm.

Albert Zholi, gazetar: Bako Xhaferaj mbetet një ndër personalitetet e këngës labe. Zëri i tij melodios, mbetet mishërimi më i mirë i këngës së vërtetë labe. Ai me thjeshtësinë e tij, me sinqeritetin por mbi të gjitha për dashurinë që ushqente për labërinë la gjurmë të pashlyeshme në këngën e Zotit.

Laert Duraj, deputet: “Çdo njeri i rëndësishëm, çdo artist rri mirë i ulur te “guri i vetë”. Edhe Hyso rrinte ulur te “guri i tij” atje në Kallarati. Por Hyso falë aftësive të veçanta të zërit e mori “gurin e tij” dhe u uli në Ansambllin Shtetëror të Këngëve dhe Valleve Popullore në Tiranë. I tillë ishte “Bilbili i Labërisë” Hyso Xhaferaj.

Zoti Bujar Leskaj hodhi idenë që për artistët të tillë si Hyso, të caktohet çdo vit “Dita e përkujtimit” të tyre, që e mira do të ishte ditëlindja, ku të zhvillohen aktivitetet të ndryshme kulturore në kujtim të tyre. Fjala vjen le të quhet, “Dita e poetit të madh të Labërisë, Lefter Çipës” ose “Dita e Bilbilin të Labërisë, Hyso Xhaferaj”, etj sepse vetëm kështu poetët, artistët e këngëtarët e Labërisë nuk do të harrohen, por do të kujtohen e vlerësohen në breza.

Bakua dhe Alvaro, në emër të familjes, falënderuan gjithë pjesëmarrësit për praninë e tyre dhe vlerësimet e bëra për Hyson, “Bilbilin e Labërisë”. Në fund një koktejl nga të zotët e shtëpisë dhe foto e përbashkët e mbylli këtë takim mbresëlënës në kujtesë të “Hysos së këngës”

“EPIKA E TRIMËRISË SË ZHULATIT” DHE LUFTËTARI MERSIN GJOÇA



Nga: Prof. Dr. Bardhosh Gaçe

Dalja nga shtypi i librit “Epika e trimërisë së Zhulatis” e studiuesit Fitim Çausi, përbën një qasje bashkëkohore të kulturës dhe historisë së Zhulatis, ai krijon premisa të reja studimi, hulumtimi, interpretimi dhe këndvështrimi, pasi është një libër i shkruar me një pasion të madh dhe ka një lloj akribie, të cilën e kanë pak libra të kësaj natyre. I gjendur para një praktike hulumtuese me burime të njohura dhe të panjohura, autori kërkon të na sjellë në vëmendjen tonë një lloj qytetërimi të hershëm, i cili për shkakun e themeleve të thella dhe të gurta, u ka mbijetuar kohërave. Mjaft e rëndësishme në këtë libër është tendenca e autorit për të krijuar udhë-vazhdimin e jetës dhe traditave kulturore, jetësore, luftarake, zakonore të zhulatasve, të cilët kanë ditur të unifikohen rreth vlerave të tyre që nga viti 165 p.e.s., ku ka dëshmi të krijimit të Zhulatis (d.m.th. pas rënies së Antigonesë së famshme), për t’u shndërruar në një fortesë të krijuar nga dora e njeriut (sipas Pukëvilis) që nga shekulli IV p.e.s., dëshmi të cilat mund të gjenden në burimet e hershme brenda dhe jashtë vendit, për shkakun e rolit që Zhulati ka luajtur në ngjarjet e rëndësishme të kohës.

Kodet sociale (të shoqërisë së kohës dhe nëpër kohë), d.m.th. marrëveshjet e çdo natyre qoftë, në paqe e në luftë, tradita e zakone nuk mund të krijohen kurrë jashtë një tradite qytetërimi, dhe në këtë rast, termi “qytetërim” ka të bëjë me elementët e qëndrueshëm etnologjik të njerëzve që nga lashtësia, të cilët i kanë ruajtur, zhvilluar dhe bërë funksionale, duke ruajtur identitetin. Ndërkaq, kjo trashëgimi e cila shpërfaq kohë të caktuara, fatmirësisht në Zhulati gjendet në një pasuri të rëndësishme folklorike dhe kulturore popullore, burimet më autentike për një kulturë të caktuar, për shkakun e natyrës që këto burime kanë, ndihmon për ta jetësuar realisht udhë-përshkrimin e Zhulatis.

Studiuesi Fitim Çausi e ka një nga tiparet e tij në punën studimore hulumtuese prurjen e burimeve të shkruara dhe burimeve të tjera. Libri për Zhulatin, në plotësinë e tij, qoftë në aspektin historik, kulturor, etnopsikologjik popullor, unitetin e brendshëm dhe reagimin ndaj ngjarjeve të caktuara, ndihmon shumë lidhur me kontekstin ku lindi dhe funksionoi Kanuni i Papa Zhulatis, kanun i cili zë fill krijimi i Kanunit të Labërisë.

Dëshmitë e shumta, përmes ngjarjeve të karakterit lokal dhe më shumë njoftojnë se ky kanun ka vepruar në Zhulat, por dhe në pjesë të tjera të krahinës së Labërisë gjatë epokës historike të Mesjetës. Këto dëshmi vijnë nga burime të ndryshme, të vendit dhe të huaja, madje dhe nga kujtesa popullore e brez pas brezi. Ndoshta, tregimet dhe tradita zakonore, jo vetëm në Zhulat, por në gjithë krahinat shqiptare që kanë pasur kanone (kanune të tillë), për shkakun e peshës e fuqinë që kishin në jetën e njerëzve, janë përcjellë dhe janë ruajtur mjaft mirë. Prania e një ligji të tillë, që gjatë periudhës historike të Mesjetës, na dëshmon në librin e autorit një trevë të unifikuar dhe identitare. Dhe kjo ka shumë rëndësi për Zhulatin.

Njëvlerë jashtëzakonisht rëndësishme në libër është pjesa historike e Zhulatis. Siç tregojnë dëshmitë që përcjell libri, Zhulati dhe Fushëbardha në çdo rast lufte



Fitim Çausi

nuk kishte kurrë më pak se 300 luftëtarë burra. E në këtë faqe, jo vetëm kujtesa popullore, këngët, rrëfimet, gojëdhënat, por dhe burime të tjera zbulojnë një traditë luftarake të përhershme të Zhulatis, i cili për shkakun e pozitës gjeografike, por dhe të traditës ka qenë e pranishme në të gjitha ngjarjet historike të Jugut. Zhulatasit janë

Libri për Zhulatin, në plotësinë e tij, qoftë në aspektin historik, kulturor, etnopsikologjik popullor, unitetin e brendshëm dhe reagimin ndaj ngjarjeve të caktuara, ndihmon shumë lidhur me kontekstin ku lindi dhe funksionoi Kanuni i Papa Zhulatis, kanun i cili zë fill krijimi i Kanunit të Labërisë.

luftëtarë të njohur. Vitet 1800, natyrisht vite që lidhen me ngjarje të rëndësishme në Ballkan, nxorën në skenë emra të njohura familjesh atdhetare (që Labëria nuk i ka pasur të pakta), luftëtarë, njerëz të dijes dhe kulturës, politikanë e atdhetarë, që çuan në plejadën e artë të Rilindjes shqiptare. E kësaj kohe është dhe familja e njohur nga Zhulati, Gjoçaj, një familje e mbrujtur me burrëri, atdhetari, trashëgimi dhe luftëtarë të njohur. Familja Gjoçaj dhe burrat e kësaj dere, në një hapësirë gati një shekullore do të gjenden në zhvillimet e rëndësishme të Zhulatis, Jugut dhe Shqipërisë. Përveç një



luftëtar i njohur, Mersin Gjoçaj, mori pjesë në Shpalljen e Pavarësisë në Vlorë dhe në mbrojtje të Qeverisë së Vlorës, ndërsa në Betejën e Skërficës kundër grekëve, ai kishte bashkëluftëtarë dy njerëz të më të rëndësishëm të luftës, Çerçiz Topullin dhe Sali Vranishtin.

Qysh në vitet 1911-1912, zhulatasit dhe Mersin Gjoça, u përfshinë në kryengritjet e mëdha antiturke të Shqipërisë së Jugut. ata, bashkëpunuan jo vetëm me Çerçiz Topullin, por edhe me Namik

Delvinën, Riza Runën, Rakip Gjolekën, baba Ahmet Turanin, Dervish Himën, siç shkruan Mihal Grameno, krahas Mersin Gjoçës, ishin luftëtarë të sprovuar si: Vehip Aliko, Sulçe Kondi, Shaban Capa, Aliko Hila, Iliaz Kola, Murat Cama, Halil Sullo, Zeman Bineri e mjaft të tjerë. Pjesëmarrja e Mersin Gjoçës dhe luftëtarëve të Zhulatis dhe Fushëbardhës, në Kuvendin e Cepos, korrik 1913, në mbështetje të Memorandumit të Gërçës dhe kryengritjes së malësorëve të Veriut, i dha një gjallëri të madhe kryengritjes antiturke në Jug të vendit, në kërkim të Autonomisë Administrative të vilajeteve shqiptare nga Porta e Lartë. Mbrojtja e trojeve shqiptare nga

copëtimi i monarkive të Ballkanit e çoi Mersin Gjoçën në beteja të tjera të përgjakshme me shovinistët. Zhulati është pjesë e rëndësishme e historisë dhe etnokulturës së Labërisë, një krahinë e cila mbart një prurje të lashtë kulturore, etnografike, folklorike, mitologjike, të këngës polifonike dhe valles, të historisë dhe traditës popullore, e në këtë kontekst, libri i studiuesit Fitim Çausi krijon një hapësirë të rëndësishme në hulumtimin, studimin dhe pasurimin e kësaj etnokulture, në thesaret e të cilës ende ka gjëra të mrekullueshme.

POEZI

Nga: Vitore Stefa Leka



Vitore Stefa Leka

Serish Pranverë

Brenda meje po harrohet
kjo stinë
Mbi shpirt Sahara shtrihet
pa fund
Lule ëndërrash më nuk mbijnë
Gjethet e fundit vjeshta
m’i shkund!



Erë pranvere!

Seç më zgjove mallin
Gjumi dimrit
e kish mpirë
Seç më drodhe zemrën
Pa ty rrinte ngrirë.
Më solle gjallërinë
Sa më kish munguar
Më ngjethet të tërën.
Det jam e trazuar
Më fute tek ti
Jam a s’jam
Se di!..



Flet piktori Astrit Beluli: Ekspozita vetjake “Labëria ime” i ka Nuk harroj fjalët e Skënder Kamberi një ndjesi të brendshme të fuqishme

Intervistoi: Albert Z. ZHOLI

Me Astritin kemi rreth 2 dekada miqësi. Jemi me origjinë nga Tepelena, por në Tiranë jemi komshi. Studio e tij është 50 metër larg shtëpisë sime dhe në atë studio mblidhen shumë tepelenas. Dhe pse në pension Astriti e hap studion në 06-30 në mëngjes dhe e mbyll në 22-00. Lëviz me biçikletë pasi këtë lëvizje e quan sportin më të shëndetshëm. Shoqëruet gjithmonë ka “Pufin” një qen tekanjos, por tepër i bukur dhe i zgjuar. Astriti i shërben qenit sikur ta ketë fëmijë. Me aq sa njoh unë miq e shok, këtë përkujdesje nuk e bëjmë as ndaj fëmijëve. Dhe Pufi krekoset kur kalon në “Don Bosko” pasi ka një “shërbëtor” besnik që ja plotëson tekat deri në detaj. Kushdjo që kalon para studios së Astritit patjetër do të ndalojë disa momente për të shlodhur sytë me pikturat e Astritit. Piktura ku dominonin jeshilja, bluja dhe e verdha. Pikturat e tij janë të shumëllojshme, por peizashi është mbreti i të gjithave, pasi vetëm në këtë lloj picture ai hedh në telajo gjithë energjitë dhe imagjinatën e shfrenuar. Një piktor që gjithmonë është i lidhur me natyrën, të bukurën dhe të veçantat e krahinës së tij. Para 5 vjetësh Astriti hapi ekspozitën e tij e katërt individuale dhe të parën në Tiranë ku ai përcollti një art të veçantë dhe plot ndjenjë. Në ekspozitën në Muzeun Kombëtar të titulluar “Labëria ime” Beluli afroi për publikun 60 piktura në katër gjini, peizazh, natyrë e qetë, portret dhe kompozim. Peizazhet zunë pjesën kryesore të kësaj ekspozite.

-Kanë kaluar rreth 5 vjet nga ekspozita e titulluar “Labëria ime” në Muzen Kombëtar. Ke nostalgji për të dhe a ke menduar për një ekspozitë të re?

E vërtetë kanë kaluar 5 vjet, por mua më duket se kanë kaluar vetëm 5 ditë. Ishte një ditë plot emocion, plot lëvizje. Kryesorja ishte lodhja parapërgatitore. Mbi një muaj stress, organizim, përqëndrim, net pa

gjumë. Nuk mund ta falja dështimin. Nuk u zhgënjeva. Kisha shumë miq rreth vetes. Pa miq asgjë nuk mund të bëhet. Madje ishin ata që më nxitën ishin ata që më nxisin. Doli një ekspozitë perfekte. Ishin të gjithë miqtë e mi ata që më inkurajuan. Ishin jashtë parashikimeve. Por ishte dhe shoqata “Labëria” ajo që më ofroi ndihmë pasi dhe vetë ekspozita titullohej “Labëria ime”.

-Pse e titulluat “Labëria ime” këtë ekspozitë vetjake?

Për të vetmen arsye pasi pjesa dërrmuese e pikturave ishin me motive nga Labëria. Pra peisazhe nga Labëria, portrete personalitetesh nga Labëria dhe kompozimë nga Labëria. Kjo trevë ka një energji të padukshme që të tërheq, të mobilizon, të frymëzon, të hap dritë në çdo moment. Kjo jo vetëm që jam lindur dhe rritur aty, por edhe në shumë shkrime, të personaliteteve të ndryshme shqiptare, kam parë që flasin me këto ngjyra për krahinën time. Shumë prej tyre janë ndërës ashtu siç ndihem unë kur flas për të, kur pikturoj për të, kur mendoj për të. Edhe sot që jam larg, edhe disa vite që isha në emigracion kur dëgjoja apo lexoja për Labërinë më rrëqethesh mishi dhe kapja penelin në dorë. Labëria ka një histori të lavdishme. Njerëzit më të ndritur të kombit si Kadareja, Agolli, Qosja etj i kanë dhënë vlerësim sikur të jetë oksigjeni i Shqipërisë. Në këtë trev kanë dal heronj, luftëtarë, dëshmorë, poetë, shkrimtarë, intelektualë që i kanë dhënë emër Shqipërisë kudo në botë. Me labërinë gjithmonë del fitimtar në luftë, në dije dhe në pikturë. Peisazhet e Labërisë janë mahnitëse.

-Kush ishte qershia mbi tortë e kësaj ekspozite?

Ajo që më la më shumë përshtypje ishte fjala e hapjes e piktorit të Popullit, Skënder Kamberi. Nuk e mendoja se do vinte dhe të hapte ekspozitën time. Por ai erdhi dinjitoz si një lab 24 karad dhe më emocionoi me fjalët që tha: “Astriti ka një stilt ë veçantë dhe një ndjesi të brendshme të fuqishme që e tregon bukur me penel”. Që në

tek Astriti?

Unë politikan bëhem vetëm ditën që shkoj për votime dhe shohit me vete për kë do votoj që t.i shërbej më mirë atdheut? Pas asaj dite politika për mua nuk egziston. Jam munduar të rri larg se është një politikë acaruese, jo kombëtare dhe që nuk e do artin. Politikanët e duan artistin vetëm në zgjedhje pasi përbëjnë problem për ta. Piktorët janë të drejtpërdrejtë, të hapur, populist, atdhetar, që nuk i durojnë padrejtësitë.

-Rreth 50 vjet me penel në dorë nuk jeni lodhur? Nuk mendoni ta lëni penelin mënjane?

Peneli është jeta ime. Jo ta lë por sikur një ditë të mos e kap me dorë do më duket se nuk kam në trup një krah apo një këmbë. As e kam menduar kurrë ta lë penelin, në asnjë moment. Pemeli më jep forcë, më angazhon, më stërvit mendjen, më shton imagjinatën, më afro me shumë me njerëzit.

-Ju thonë se piktura është vetë jeta juaj. Po si edhe apo si trokiti piktura te Astriti?



Astrit Beluli

- Peisazhet e Labërisë janë mahnitëse ndaj për të kanë folur Agolli, Kadare dhe Qose.

-Në shumë momente shoh politikë acaruese, jo kombëtare dhe që nuk e do artin, ndaj distancohem.

- Piktorët janë të drejtpërdrejtë, të hapur, populist, atdhetar, që nuk i durojnë padrejtësitë.

fëmijëri e kasha idhull dhe se mendoja se ai do ishte kaq i thjeshtë, kaq njerëzor, kaq dashamirës ndaj një piktori. Të gjithë e dimë se ndaj artistëve ka xhelozie. Por tek Skënderi në aq biseda që kam zhvilluar nuk kam vënë re asnjë fije xhelozie ndaj shokëve të tij, madje, madje ai e shpreh publikisht vlerësimin e mirë ëpr piktorët me vlera. Kjo e dallon atë nga të tjerët. Kjo e bën atë të veçantë dhe shumë të dashur në rrethet e piktorëve.

- Keni piktura të panumërta dhe kenë lëvruar të gjitha gjinitë deri tek abstraksioni, po politika a ka ndikuar

Kush ishin mësuesit tuaj që ju kanë nxitur dhe përkrahur për pikturën?

-Zanafilla e e emocionit ka qenë që në shkollën tetëvjeçare kur në klasë të 5 kam pasur një profesor që kishte mbaruar liceun për skulpturë, quhej Xhelal Lushaj. Një ditë pushimi të gjatë kur nxënësit dilnin në oborrin e shkollës jashtë, ai kishte marrë një gur atje me një daltë dhe me një çekiç dhe po ndërtonte një figurë. Ne si kureshtar shkuam dhe po shikonim me vëmendje dhe ai arriti të ndërtojë portretin e Skënderbeut dhe e realizoi në një mënyrë që lexohej.



“Mbuloi pritshmëritë” Astriti ka një stil të veçantë dhe eme që e tregon bukur me penel”

Portreti ishte 80 me 60 mbi një gur masiv. Ai punoi gati 3-4 ditë dhe kur e mbaroi ne shkollim atje ta ruanim që mos ta prishte njeri. Kjo ishte nxitja që unë fillova këtë rrugë për artin figurativ. Në atë periudhë ne laheshim nga lumi, në lum kishte dhe argjilë dhe ne atje lyheshim me të. Argjila më ngacmoi. Një ditë mblodha argjilë dhe ndërtova një bust të Selam Musait. Ne e kishim bustin e Selam Musait në dalje të Tepelenës në rrugën e Vlorës. Shokët e mi e morën në tezgë dhe e çuan para pallatit tek shkolla. Vinin të gjithë e shikonin. Unë nuk e dija se kjo duhej të mbrohej dhe duhej të mbulohej me një leckë të lagur që të ruhej nga vapa. Skulptura u çua dhe të gjithë të lagjes u mërzhitën. U detyrova të gjeja allçi, afërsisht një thes dhe e përziem me gëlqere. Me këtë përzierje me një thikë e ndërtova dhe bëra përsëri Selam Musain, të cilin më pas e lyem me një bojë vaji dhe e mbajtëm te lagjja. Mbas mbarova shkollën më aktivizuan tek lidhja e shkrimtarëve dega e Tepelenës. Kam marrë pjesë në çdo aktivitet të tyre dhe në fund hapa një ekspozitë me 36 punime rreth vitit 1982 në Tepelenë ku kisha peizazhe dhe portrete. Atë kohë kam marrë disa çmime të dyta për portrete dhe u shitën afro 17 piktura dhe të tjera u shitën nëpër ndërmarrje dhe institucione. Në vitin 1997 shumë u dogjën, u vodhën dhe u prishën.

-Të shkoje në shkollë të pikturës në sistemin komunist ishte e vështirë. Kur e filluat dhe si e kujtoni shkollën. Kur e keni mbaruar shkollën për pikturë?

Në shkollë shkova me konkurrim. Konkurrimi atë kohë nuk njihje miqësi. E kam mbaruar në vitin 1976 në Tiranë, pastaj fillova punë në Tepelenë, kalova si mësues vizatimi në shkollën tetëvjeçare “Avni Rustemi”. Pastaj kam punuar në të gjithë rrethin e Tepelenës si në Memaliaj 12 vjet, Hormovë, Qesarat, Kras, Sinanaj, 4 vjet, Gusmar, pastaj Memaliaj pastaj përsëri në Tepelenë deri në vitin 1998. Më vonë ika në Greqi me gjithë familjen, pastaj u kthyem në Tiranë.

-Astriti dhe emigracioni. Në emigracion shkon për mbijetesë dhe arti lihet mënjanë. Në Greqi a je marrë me pikturë?

Realisht atje nuk jam marrë shumë me pikturë, kam bërë portrete, peizazhe me porosi. Më vonë u kthyem në Tiranë, sepse ishte vendi më i mirë për të jetuar dhe kishte më shumë mundësi pune. Në Tiranë kam bërë piktura të të gjitha gjinive por kryesisht me porosi. Kam një nostalgji të madhe për të realizuar peizazhe nga vendlindja, nga Tepelena dhe shkoj çdo muaj në Tepelenë ku hedh ndonjë peizazh dhe vij dhe e ripunoj këtu. Kam hapur një ekspozitë në Sarandë, Tepelenë, Ksamil, të cilat kanë lënë gjurmë. Jam ndjerë mirë dhe këto kohët e fundit pasi jam mbushur me pictura, sepse pata një boshllëk me kurbetin. Tani ndjehem mirë.

-Po Enver Hoxhën e ke pikturuar ndonjëherë?

Enver Hoxhën e kam bërë njëherë kur isha mësues në Sinanaj. Atë kohë Enveri ka pas

ardhur njëherë në Sinanaj në Lops, por nuk e mbaj mend mirë datën. E bëra në fasadën e shkollës sikur ishte midis blegtorëve, pionierëve.



-Po nga udhëheqja e kohës komuniste ke bërë ndonjë portret apo ndonjë pikturë?

Kam bërë më shumë portrete dëshmorësh. Kur u hap një ekspozitë në Tepelenë me piktura dhe më bënë edhe anëtar të Lidhjes në vitin 1986 më dhanë një autorizim për të bërë portretin e dëshmorëve që nuk kishin fotografi apo ato që ishin viktimat të luftës siç ishin në atë kohë. Bëra gati nja 80 grafika. Kam bredhur në të gjithë fshatrat e Tepelenës me qëllim që të takoja të afërmit e tyre dhe të gjeja ngjashmëritë me djemtë, nipërit e tyre, të afërmit dhe duke shtuar edhe vetë nga imagjinata. Të gjitha këto piktura u vunë në fondin e muzeut ku ishin 80 portrete. Jam marrë me



rrethet e pikturës në Tepelenë, Memaliaj ku kam nxjerrë talente dhe kam punuar me përkushtim, ku shumë prej tyre janë bërë talente dhe janë plot energji në Itali, Gjermani, Amerikë, Greqi.

-Kur keni marrë çmim dhe si?

Në vitin 1989 në Tepelenë u hap një ekspozitë ku unë kisha bërë një portret lab tipik midis pikturave të tjera dhe mora çmimin e parë. Atëherë ka qenë Gramoz Ruçi, Sekretar i Parë në Tepelenë. Ka qenë

dhe një sekretar tjetër që ishte nga Saranda erdhi në Tepelenë. Kur u hap ekspozita ata u afruan e panë dhe u kthyen prapë të shikonin portretin, kjo ishte në fillim të ekspozitës. Një ndër kuadrot e Tepelenës,

-Mendoj me sa kam intervistuar se kishte kërkesë llogarie në kohën e sistemit komunist për pikturën dhe kjo kërkesë a e lartësonte pikturën më shumë se sa sot?

-Atëherë kishte përgjegjësi më të madhe që të bëje një pikturë se sa sot sepse, nëse do të bëje pasarelën e Ali Pashës, do ta bëje në një mënyrë perfekte me një realizëm që të kishte dhe kohën brenda dhe çdo gjë që i përkiste periudhës, por jo ekzagjerime. Ndërsa unë personalisht jam lidhur shumë me peizazhin, me natyrën, me lëvizjen. Jam njeri që e dua natyrën dhe e dua jetën. Në të gjithë pikturat e mia ka jetë brenda.

-Shikoj që më shumë je te peizazhi, portreti, dhe te kompozimi....

Kam bërë dhe piktura të kompozuar dhe një nga pikturat e para që kam kompozuar ka qenë ajo e Polo Bezhanit. Ai ka qenë kompozimi im i parë i imi. Natyra më pëlqen shumë pasi Tepelena ka një reliev shumë të thyer, ka male, borë, luginë, kodra, fushë, livadhe, pemë të shumëllojshme lumenj, këto janë pasuri që mua më magjepsin. Përsa i përket portretit, mua më pëlqen sepse në portret shumë njerëz i përjetëson. Përjetëson vlerat e njeriut. Portretet nëse nuk do ti bëjmë atëherë ata njerëz të veçantë do të harrohen. Në ditët e sotme unë kam bërë shumë portrete për fëmijë, pleq e plaka, dëshmorë.

Ata që ngritën këngën labe në Tepelenë Maliq Lila ngriti polifoninë labe në Tepelenë e ngriti në një stad aq të lartë sa që Tepelena konkurronte atëherë me qytete më të mëdha. Duke u nisur nga kjo unë ndjeva një detyrim brenda vetes t'i bëja një portret. Mendova që këtë portret mund ta çoja edhe në shtëpinë e Maliqit, por atje mund ta shikonin vetëm pak njerëz, kurse jeta e Maliqit nuk ishte vetëm shtëpia. Ai shkonte e flinte atje. Ai punonte në shtëpinë e kulturës deri në 2 të natës, sa herë do bëheshin koncerte, festivale apo përshëndetje. Maliqi do ishte i pari dhe i do të rrinte deri vonë. Kjo ishte shtëpia e parë e Maliqit dhe ajo gjenetikja e dyta. Mendova se ky portret mund të rrijë më mirë në shtëpinë e kulturës por jo në zyrën e drejtorit, duhet të rrijë tek hollit. U ndjeva i lehtësuar që e çova dhe atje e mirëpritën, më përshëndetën dhe më falënderuan shumë. Tepelena ka nxjerrë njerëz të mirë dhe të shkëlqyer dhe që kanë kontribuar në mënyrë të papaguar. Tani po bëj Zaho Balilin, organizator në grupin e Hormovës ka bërë rreth 11 vëllime me poezi, tekste të polifonisë labe, ka ngritur grupin e Rexhinit, të Hormovës. Me lëvizjen demografike njerëzit kanë ikur njerëzit dhe nuk ka më grup polifonik. Grupi i Rexhinit në atë kohë këndohej në festival kënga e bilbilenjëve, ose grupi i Hormovës, “Flaka mbuloi fshatin” ku udhëheqës artistik ishte Zaho Halili dhe mori çmim të parë. Zaho ka një kontribut shumë të madh. Gjithë ato tekstet e Zahos që i këndojnë grupet polifonike që nga lumi i Vlorës i këndojnë këngëtarët si Poni, Maja, Aurela Gaçe. Le të shërbejë kjo ekspozitë si një urim zemre për Labërinë që na dha qumështin dhe na mëkoi dashurinë për atdheun.

Gurali Bardhi u afrua dhe tha: Kush i ka bërë këto pikturat? Drejtori më prezantoi dhe ata më pyetën: Mos është Fejzo Duka ky në portret? Po i them unë. Ai thotë se kur kam qenë sekretar në Sarandë kam qenë në shtëpinë e Resbat Dukës të birit të tij. E ke bërë origjinal më tha. Ndërsa Gramoz Ruçi shtoi: Ky është një portret që personifikon malin e Labërisë. Është një mal që flet. Edhe shokët e mi kishin shumë piktura të bukura. Pastaj mbas vitit 1990, filloi një pauzë ku unë u mora me ndërtimin e një shtëpie se ishim shumë fëmijë. Më vonë vazhdova punën si mësues bëja portrete dhe peizazhe dhe kryesisht për njerëzit që i donin. U prish dhe Lidhja e Shkrimtarëve dhe Artistëve ku me anë të saj bënim ekspozita që na stimulonin,

pra u prish ritmi, organizimi. Pastaj ika në Greqi. Mbas viteve 2010 unë jam marrë seriozisht me pikturën, kam punuar shumë mirë dhe kam hapur ekspozita në Tepelenë dhe qytete të tjera. Kisha shumë dëshirë që pikturat e mia të kishin tematikë nga Tepelena. Ndaj në gjithë peizazhet e mia shumë vend ze Tepelena. Kam bërë vendet ku kemi bredhur, ku jemi larë, në ujë të ftohtë, të shkëmbi i madh, luginën e Bënçes, Dragotit.

ASPEKTE DHE PROBLEME USHTARAKE TË REVOLUCIONIT TË QERSHORIT



Nga: Bashkim Qeli

Në historiografinë ushtarake të popullit shqiptar, për liri dhe pavarësi, një vend të rëndësishëm zë edhe Revolucioni Demokratik i Qershorit 1924. Pas Kongresit të Lushnjës dhe largimi i pushtuesit italian më 1920, lëvizja demokratike revolucionare mbarë shqiptare në vendi tonë, hyri në një fazë të re historike. Ky revolucion shpërtheu si domosdoshmëri historike, në një kohë kur ishin pjekur edhe faktorët objektive dhe subjektive. Më 13 tetor 1922 në Vlorë, me nismën e Avni Rustemit u krijua Shoqata "Bashkimi". E cila grumbulloi në gjirin e saj patriot demokrat, punëtor, fshatarë, intelektual veçanërisht nga rinia përparimtare. E cila nga tetori 1922 deri në prill 1924 kishte krijuar tre degë në Tiranë, Vlorë dhe Durrës. Të cilat dhanë një ndihmesë të madhe për gjallërimin dhe lëvizjen demokratike antifetare. Në themel të tij, qëndronin kërkesat e masve popullore për përmirësimin e gjendjes së mjerueshme ekonomike, sidomos fshtarësia, që kërkonte zgjidhjen e problemit të tokës, si dhe nevoja për demokratizimin e jetës në vend, kur regjimi çifligar shtypte me çdo mjet të drejtat e masve popullore.

Fazën më të lartë lëvizja demokratike shqiptare e ariti, në pranverë, pas vrasjes së Avni Rustemit në prill 1924, Shoqata "Bashkimi" i bëri thirrje popullit për shpërthimin e kryengritjes së armatosur. E cila përfundoi më përmbysjen e qeverisë reaksionare çifligare, duke krijuar edhe parakushtet për realizimin e objektivave, që kishte kjo lëvizje, për të vendosur

100 Vjetori, 1924 -10 Qershor - 2024


prijsit popullor si Bajram Curri më shokë, dhe komandantët e grupeve ushtarake të Shkodrës dhe Përmetit, ku u parashikuan masat e problemet e duhura dhe u zbatuan masat konkrete, që do të zgjidhet strategjia ushtarake.

Siç ishin realizimi i udhëheqjes strategjike të forcave kryengritëse; përgatitja dhe drejtimi i tyre; përcaktimi i drejtimit dhe ides së zhvillimit të kryengritjes së armatosur; përcaktimi i rrugëve për zgjidhjen e problemeve të armatimit dhe sigurimit materialoteknik; realizimi i bashkëpunimit

strategjik dhe krijimi i rezervave strategjike.

Shpallja e grupeve ushtarake të Shkodrës dhe Përmetit, kundër qeverisë reaksionare çifligare mundësoi, që komisioni si organ drejtues politik ushtarak i kryengritjes, të zgjidhte shpejt problemin e caktimit të komandantëve, që do të drejtonin veprimet luftarake gjatë zhvillimit të veprimeve luftarake, ashtu edhe shtimin e rradhëve të forcave kryengritëse me luftëtarë të rinjë. Drejtimin e përgjithshëm të kryengritjes e mori Komisioni Administrativ me në krye F. Nolin. Ky komision mundi të sigurojë bashkëpunimin me demokratët të tjerë si B. Currit dhe komandantët e grupeve të Parë dhe Tretë ushtarak në Shkodër dhe Përmet. Gjatë fazës së parë të kryengritjes, Komisioni mundi të realizojë drejt, jo vetëm drejtimin politik, por u dha zgjidhje edhe problemeve ushtarake. Ai përcaktoi drejt shtabet, që do të drejtonin veprimet luftarake të forcave në kryengritjen e armatosur, dhe komandantët e tyre. Si udhëheqës i veprimeve luftarake për Prefekturën e Kosovës, si komandant të Përgjithshëm caktoi B. Currit, për zonën

ekonomiko shoqërore të masave popullore revolucionare, të arrihej me forcat dhe mundësit e veta të përmbysjes regjimi çifligar dhe t'i hapet rruga demokratizimit të pushtetit shtetëror dhe të përmirësohet



gjëndja ekonomike e popullit.

Fillimisht, për organizimin e forcave kryengritëse u shfrytëzua gatishmëria e tre grupeve ushtarake, që ishin hedhur në krahun e revolucionit, forcat kryengritëse të B. Currit dhe forcat ushtarake të garnizoneve të Shkodrës dhe të Përmetit. Ai synonte, që forcat kryengritëse të përqëndroheshin në tri zona kryesore, në Prefekturën e Kosovës, të Shkodrës dhe në trekëndshin Vlorë Tepelenë Përmet Skrapar. Për pjesëmarrjen në radhët e forcave kryengritëse u zbatua parimi i

Në historiografinë ushtarake të popullit shqiptar, për liri dhe pavarësi, një vend të rëndësishëm zë edhe Revolucioni Demokratik i Qershorit 1924. Pas Kongresit të Lushnjës dhe largimi i pushtuesit italian më 1920, lëvizja demokratike revolucionare mbarë shqiptare në vendi tonë, hyri në një fazë të re historike. Ky revolucion shpërtheu si domosdoshmëri historike, në një kohë kur ishin pjekur edhe faktorët objektive dhe subjektive.

vullnetarizmit. Ne veri të vendit u zbatua parimi "burrë për shtëpi", mbështetur në traditën e malësorëve. Në jugë në emër të revolucionit, u bë thirrje për të mobilizuar rezervistët, të cilët kompletuan grupet ushtarake, që u krijuan, edhe në zona të tjera të vendit, thirrjes për rryengritje ju prgjegjen me qindar mijë vetë.

Një pjesëmarrje e tillë përcaktoi edhe karakterin popullor mbarëkombëtarë të kryengritjes, si një bashkim vullnetarë padallim krahine, feje dhe ideje, të cilët ishin të vendosur në luftën e tyre. Kjo pjesëmarrje siguroi një raport forcash 1.5 me 1 në favor të kryengritësve. Në fund të muajit majit u formua Komanda e Përgjithshme Operative në jugë me komandant Kasëm Qafzezi e cila mobilizoi forca nga Përmeti,

Tepelena Vlora dhe Skrapari, të cilat u futën në radhët e forcave aktive të ushtrisë. Komanda e Përgjithshme Operative e Jugut me shpejtësi bëri riorganizimin e forcave, mbi bazën e grupit të Përmetit u organizuan dy grupe, Grupi 1 dhe Grupi 2 me qëndër përkatësish në Vlorë dhe Përmet, me komandant Kasëm Radovicka Grup 1 dhe Shefqet Korça grupi 2. Grupi 1, kishte 2 batalione një me ushtarë aktivë e vullnetar vlonjat dhe tjetri me rezervist dhe 250 xhandarë vullnetarë. Grupi 2,

kishte dy batalione të përbërë me rezervist dhe vullnetarë nga Përmeti, Tepelena dhe Skrapari.

Në Shqipërinë verilindore organizimi u bë në bazë të çetave dhe grupçetsh, të krahinave si ajo e Krasniqës, Hasit, Bytyçit – Berishës, Gashi-Shipshanit, Nikaj Mërturit e të Lumës. Për zonën e Shkodrës ishin forcat vullnetare, ato që kaluan në varësi të komandës ushtarake të Grupit 3. Ky ndërtim i rendimit të forcave u ruajt deri në arrijtjen e fitores ndaj forcave qeveritare, i cili pësoi ndryshime gjatë zhvillimit të kryengritjes sepse pas çdo luftimi forcave u shtoheshin me vullnetarë nga forcat e qeverisë, që dorzoheshin dhe hidheshin në anën e revolucionit.. Në



kryengritjen e përgjithshme, këmbësoria ishte arma kryesore. Me përfshirjen edhe të forcave të grupimeve ushtarake u mundësua edhe përdorimi i armës së artillerisë. Gjatë luftimeve. Kryengritësit ishin të ndërgjegjshëm në drejtësinë e luftës së tyre, sepse luftonin për kushte më të

mira ekonomike dhe demokratizimin e jetës së vendit. Kjo mundësoi, që kryengritësit të shfaqnin gjatë luftimeve vetit dhe virtytet më të mira si patriotizmi, guximi, trimëria,

mençuria, shpirti sumues përballimi me sukses i vështirësive të luftës. Komanda e Përgjithshme një vëmendje të veçantë i kushtoi organizimit dhe drejtimit të kryengritjes. Kjo u varë nga kushtet e rrethanat, nga mjetet e teknika, nga largësia ndërmjet tre grupeve kryesore e reperteve e grupçetave kushtëzuan edhe mënyrën e drejtimit.

Gjatë zhvillimit të kryengritjes u praktikua dërgimi i urdhërave dhe informatave me shkresa në ndonjë rast u bë lidhja me mjete telefonike, për komunikimin ndërmjet tre grupimeve me repartet dhe me lajmëtar (korrierë), i vetmi mjet për njoftim për gjëndjen e forcave ndërluftuese ishte linja telefonike. Kështu njoftimi për fillimin e kryengritjes me sulmin mbi Krume ju bë Vlorës nga Puka, ndërsa nga Vlora shpallej se sapo të bjerë Kruma do të filloi revlucionit. (AQSH, F.818, D.8/2, v1924.f.521) Komandantët e Grupeve Ushtrake e zgjidhën drejt zgjedhjen e emërimit e komandantëve të çetave, zbatohet parimi i zgjedhjes se tyre nga vetë luftëtarët, duke caktuar në këto funksione luftëtarët më trima, të zgjuar me aftësi organizimi e drejtimi, ashtu siç ishte vepruar edhe gjatë LSHP, kryengritjeve 1909 -1912, dhe Luftën e Vlorës më 1920.



një rend më të përparuar ekonomik e shoqëror. Vendimi për fillimin e kryengritjes së armatosur shtronte përpara lëvizjes demokratike shqiptare detyra të rëndësishme organizative e ushtarake. Duke qënë se, për përmbysjen e qeverisë çifligare dhe për demokratizimin e jetës shoqërore do të zgjidheshin me anën e luftës së armatosur. Komisioni Administrativ i formuar në Vlorë në maj 1924, për drejtimin e kryengritjes do të bashkëvepronin me

e Shkodrës caktoi komandantit e Grupit të tretë, Rexhep Shalën dhe për Shqipërinë e Jugut caktoi komandantin e Grupit të parë Kasëm Qafzezi. (AQSH, F.885, D.20, v.1924. f.9)

Krijimi i Komisionit Administrativ dhe tri komandave të operacioneve, jo vetëm në vështrimin politik por edhe në atë ushtarak, shënonte fazën më të lartë të përgatitjes së kryengritjes së armatosur. Ajo kishte si qëllim, që duke u mbështetur në gjëndjen moralopolitike dhe

Buronjat e Kuçit n



Nga: Agim Çiraku
Kryetar i Shoqatës Labëria
"Nderi i Kombit"

Në kuadrin e 80 vjetorit të festimeve Çlirimit të Atdheut, si dhe në nderim të 82 vjetorit të çlirimit të Kurveleshit, të dëshmorëve, heronjve, luftëtarëve partizanë që dolën me armë në dorë për çlirimin e vendit nga okupatorët nazi-fashist, si dhe të gjithë shqiptarëve dhe patriotëve që e mbështetën këtë luftë, ditën e djelë më 23 qershor, Komisioni Organizator dhe Kryetarët e fshatrave të krahinës së Kurveleshit përkujtuan në Burronja të Kuçit, jehonën e fuqishme "Para Partizan" dhe qëndresën legjendare në shekuj të popullit të kësaj krahine. Labëri t'u mblodhën djemtë në festime si nga mot... Një breza faqe ndritur një urim nga zemra plot !



Nuk ka asnjë vend tjetër në Evropë, që toka e tij të jetë pëllëmbë e barut, sikurse është toka e lavdishme e Kurveleshit dhe e tërë Labërisë. Ndaj, ky fakt më bën të ndihem 2 herë krenar që jam sot këtu para jush: **Së Pari** duke përfaqësuar një emër të lavdishëm sikurse është Shoqata Atdhetare Kulturore "Labëria" dhe: **Së Dyti** i privilegjuar që përfaqësojë SI

Ç'DO FAMILJE E Labërisë paraardhësit e mi që u bashkuan me fitimtarët për interesin Kombëtar, dhe që luftuan me sakrificë sublime që nga Abduraman Çiraku, i cili në tetor 1912 u largua nga Turqia për t'ju bashkuar Ismail Qemalit në shpalljen e Pavarësisë, ku dhe u caktua prej tij si kreu i Policisë, ndërsa në Luftën e Vlorës 1920, e shtëna e topit të Abduramanit, komandat i artillerisë shënoi fillimin e luftës dhe fitores së saj. Edhe gjatë Luftës së Lavdishme Antifashiste Nacional-Çlirimtare Xhule, Qemal, Jonuz dhe Seit Çiraku u rreshtuan me Brigadën e 6-të Sulmuese duke luftuar në Çlirimin e vendit deri në Kosovë. Ndaj nderimi për dëshmorët dhe partizanët, është dhe do të mbetet nderim për luftën dhe Kombin. Për të kaluarën, pa të cilën nuk ka të ardhme të sigurtë.


Në këtë të veçantë ajo që na bashkon, është kujtimi për idealin e dëshmorëve që derdhën gjakun për atdheun. Por në këtë ditë të veçantë një falenderim shkon për kryeministrin, kryetarin e PS-së dhe deputetin e Vlorës z. Edi Rama, që me investimet e jashtëzakonshme që ka bërë në krahinën e Labërisë, për rrugët, ujsjellsat, turizmin malor, bujtinave etj. do të mbetet përjetësisht në historinë e Krahinës së Kurveleshit dhe gjithë Bregut të Jonit. Janë këto investime që na e bënë më të lehtë bashkimin dhe pjesmarrjen e sotme në këtë ngjarje të rëndësishme, ku Kuçi dhe Bregu janë shkrirë në një të vetme. Një nderim i veçantë i takon Komisionit Organizator dhe Kryetarëve të fshatrave të krahinës së Kurveleshit: Bolenë, Çorraj, Fterrë, Golëm, Gusmar, Kallarar, Kapariel, Kolonjë, Kuç, Kuç-Buronja, Lekdush, Nivicë, Rexhin, Picar, Progonat dhe Vermik. Në cilësinë e kryetarit të SH.A.K.Labëria më duhet të falenderoj miqtë, anëtarë e drejtuesit lokalë të Shoqatës Atdhetare Kulturore "Labëria", deputetët Gjijnuri, Klosi, Sinaj, Ministren Denaj, prefektët e qarqeve Vlorë e Gjirokastrë Vangjel Tavo e Odise Kote që u kujdesët për këtë ditë



Nënë Krijesin e Velup Bunës
Cel e Kurveleshit No 1911

të veçantë si dhe Bashkinë e Himarës që e mbështeteti këtë Event. Zëri i këngëtarve të Labërisë ishte edhe amaneti i heronjve për të treguar se Kurveleshi nuk i harron partizanët, bijët dhe bijat e këtij populli që e çliruan krahinën e tyre 82 vite më parë. Por kjo ditë është edhe një homazh për të gjithë dëshmorët, luftëtarët dhe Brigadat partizane që derdhën gjakun dhe sakrifikuan për çlirimin e Shqipërisë dhe trojeve shqiptare në Kosovë. Festa labe mblidhet sot plot gëzime plot me derte, të kujtoj betejat zjarr, që nga lufta jetë merte.

Bënte luftë e bënte këngë,
që të dyja lidhur fort.
Kush me mall se pret Heroin...
Memo Meto vall vjen sot ?



Burronja e Kuçit, gurgullima e ujrave të saj joshëse, ka rrjedhur nëpër shekuj, duke shpërndarë bashkë me freskinë, edhe jehonën e luftrave dhe qëndresën legjendare të këtij populli për ekzistencë. Në rrjedhën e gjatë shekullore, ujët e saj është kthyer në blerim, në lëvizje, në kujtesë për tërë ato festime nëpër vite, ku bashkë me popullin e krahinës, mernin pjesë

edhe dëshmorët e heronjtë e Kurveleshit, kësaj krahine heroike, që e vaditi tokën arbërore me gjak rinor. Në saj të këtij gjaku të derdhur, Kurveleshi ka përballuar agresione të shumta dhe ka dalë fitimtar, sepse u mbështet mbi traditat luftarake, kapërxeu në zjarr e në flakë, në vuajtje e mundime, duke e vaditur fitoren e madhe të çlirimit me gjakun e shenjtë të mija partizanëve... Malet e Kurveleshit legjendar, panë sesi u përsërit historia heroike, panë çetat partizane, që kishin rrokur armët të frymëzuara me idealin e lirisë, panë goditjet e rrufeshme, që iu dhanë pushtuesit të vendit nga fshatarë e partizanë të një ideali, të cilët mbollën fjalën e lirisë dhe entuziazmin e fitores. Kurveleshi mbeti kala e pamposhtur e rezistencës antifashiste. Partizanët, bijtë e këtyre maleve, ishin zemra e popullit. Prej tyre ranë në luftë të përgjakshme për lirinë e Atdheut shumë dëshmorë dhe heronj. Nuk ka asnjë vend tjetër në Evropë, që toka e tij të jetë pëllëmbë e barut, sikurse është toka e lavdishme e Kurveleshit dhe e tërë Labërisë. Tek Buronjat e Kuçit, këtij fshati me 70 dëshmorë dhe pesë Heronj të Popullit, në qershorin e çdo viti, vijjnë banorët e këtij trualli për të festuar ditën historike të Çlirimit të Kurveleshit, i cili gjatë viteve të Luftës Antifashiste, ka pasur disa çlirime, sikurse ishte ai i nëntorit 1942. I dërguari i prefekturës në mitingun e Gusmarit, ku ndodhej postkomanda e qeverisë fashiste për Kurveleshin, raportonte: "Në Gusmar gjetëm shumë popull dhe parësi të Kurveleshit. Kryetari ishte Mustafa Matohiti. Populli e pëlqeu Mustafa Matohitin. Ai na porosi për t'i dhënë Qazim Kocullit këto kondita: Të mos çarmartos popullin. Në Gusmar mund të kthehen vetëm karabinierët shqiptar. Karabinierë italian dhe milici shqiptare nuk pranojmë. Të lirohet Shefqet Peçi nga burgu. Të bëhet ndryshimi i n/punësave të sotëm. Pagimin e dëmeve të luftës deri në 25 dhjetor. T'i shpërndahet popullit deri në tre muaj miell, duke llogartur nga 10 kg miell në muaj për frymë. Të mos ndiqen të aratisurit politik." Pas mitingut të Gusmarit, i cili entuziazmoi shumë popullin e krahinës, qeveria nxjerr traktin: "Kurveleshas ditën e 28 Nëntorit një çetë hajdutësh dhe të çmendurish, dëbuan nga Gusmari autoritetet e shtetit. Qeveria Mbretnore ka vendosur t'i shtypë këto vepra të turpshme dhe aktorët e tyre. Dorzoni vetë

në festën e madhe



në luftë të masave të gjera të popullit me veprimtarinë luftarake të formacioneve partizane të rregullta si njësi të një ushtrie të vërtetë popullore revolucionare. Në të gjitha operacionet Shtabi i Përgjithshëm përcaktoi qartë momentin politik dhe ushtarak për përqëndrimin e forcave në drejtimin kryesor më të përshtatshëm për dhënien e grushtit kryesor, karakterin e manovrës, taktikën që duhej përdorur etj. As pushtuesi fashist, as reaksioni i brendshëm dhe as ndërhyjet e presionet e prapaskenat e aleatëve e të agjentëve të tyre, nuk mundën të pengonin

zbatimin e strategjisë e të taktikës, që kish caktuar udhëheqja e Luftës Nacionalçlirimtare, nuk ndaluan zbatimin e detyrës përfundimtare për çlirimin e vendit. Fakti që në skenën politike shqiptare të Luftës së Dytë Botërore, populli shqiptar nuk u mashtrua nga kolaboracionistët, por shkoi pas Frontit Nacionalçlirimtar, tregon për progamin që i dha popullit, për perspektivën që i çeli, dhe rrugën e nderit që ndoqi. Drejtimi politik i Luftës Antifashiste në Shqipëri, çoi në dëbimin e pushtuesve të huaj dhe në përmbysjen e regjimit të vjetër, në garantimin e tërësisë territoriale të Shqipërisë, që u rrezikua në Konferencën e Parisit në 1946.

03

Në këtë klimë politike dhe ushtarake, Kurveleshi ishte çuar i tëri në këmbë, zemrat e popullit rrahën me vrullin e stuhisë, që do ta shpëtonte vendin nga okupatori. Malet e saj mbeten si kurorë natyrore, që Luftën e Madhe të Kurveleshit tregojnë, por edhe flijimet e rinisë, flasin më qartë për sarificat që kërkonte Fitorja përfundimtare. Prandaj edhe nënat e

Labërisë kanë kënduar: Çfarë ndodh me juve kështu, vitet tutje ju tëhu...

Do këndoj këngën e trimave për ata që flenë lëndinave... Labëria mbetet djepi i shqiponjave, djepi që përkundi trima, sepse Labëria historikisht kokën e ka mbajtur mbi dyfek, dhe zemra e saj ishte flakë e vetëtim. Labërit i janë betuar Atdheut të shenjtë: Ke në besë një Labëri! Bijtë e Labërisë e kishin zëmren me çika, e mbanin pallën në supë dhe kur e dredhin vallen, ju qeshte nuri. Në këtë festë leberit mblidhen, porsizgjojt' e bletës, u ka hije krenaria. Çfarëdo furtunash të vërshojnë mbi truallin e saj, Labëria gjatë historisë do të mbetet krenaria e Kombit, palca e një populli të pamposhtur sikurse ka kënduar edhe Populli:

Bilbil Matohiti malli ç'na ka pikur;
trimëria jote, heroizm' i ndritur.
Bijtë e Labërisë derdhur vetëtimë
Luftës Çlirimtare i dhanë gjithë rininë.

Labëri e trimërisë në këtë festë të lirisë, duket e çelur si zambak mbi gurë. dhe sot duket se ngrihet jehona e shpirtit të popullit, i cili përballoi me heroizëm dy perandori të mëdha që sajuan Luftën e Dytë Botërore; populli i Labërisë, si dhe i tërë popullit shqiptar. Labëria ka qenë përherë maj jatagani, i ka mbajtur nëpër kohra luftëtarët e lirisë të bashkuar, si në brezin e gjerdanit. E kemi detyrë t'ia ngremë Labërisë më lart historinë e shkruar me gjak, sepse historia e saj do të mbetet e kuqe si një zambak, për t'ia lënë trashëgim brezave. Thesaret më të mëdha të Labërisë janë heronjtë e saj dhe këngët për ta:

Labëri male në qiell;
fjala shpat e zëmra diell.



armët me vullnetin tuaj se do të vini në plumb pa gjyq". Jehona e kësaj ngjarjeje entuziazmoi shumë popullin e krahinës, sepse i gjithë Kurveleshi ishte me Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare, prandaj nuk u trëmb nga presionet e pushtuesit. Historikisht Kurveleshi kishte qëndruar i paepur para pushtimeve të huaja, dhe trimërinë, sakrificën e kishte lënë trashëgim në brezat pasardhës. Bashkimi i popullit shqiptar, i dha Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare zgjerim dhe rritje drejt fitores përfundimtare. Këshilli Antifashist Nacionalçlirimtar përpunoi, zhvilloi, dhe zbatoi me sukses taktikën, strategjinë dhe artin ushtarak gjatë Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, organizoi dhe fuqizoi ushtrinë, si krahu i armatosur i revolucionit popullor dhe Frontin Nacionalçlirimtar si krahu politik i Ushtrisë Nacionalçlirimtare, dy armët kryesore për fitoren mbi okupatorin. Organizimi i kryengritjes së armatosur dhe gërshetimi i Luftës Antifashiste me revolucionin popullor, i dha Luftës Antifashiste fitoren përfundimtare, sepse e drejtoi Luftën Nacionalçlirimtare si pjesë përbërëse të Frontit të madh antifashist botëror. Duke u mbështetur në kushtet konkrete të vendit, ku fshatarësia përbënte shumicën e popullsisë dhe kishte tradita të shquara patriotike e luftarake, Këshilli i Përgjithshëm Antifashist Nacionalçlirimtar e ktheu fshatin në terrenin kryesor, ku u zhvillua kryengritja e armatosur në formën e luftës partizane kundër një ushtrie superiore me një teknikë ushtarake moderne. Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë çlirimtare, e udhëhoqi këtë luftë me synime politike e ushtarake të përcaktuara mirë, e cila do të shkrinte në një rrymë të vetme hedhjen



Djepi që përkundi trima,
zemrat flak' e vetëtima.

Në shekuj mbete kala:
ata lart, e ti mbi ta!
Nuk t'u shterr fuqia kurrë,
gjaku yt mbet në flamur.

Labëri kurorërgjëndi
madem i këtij vëndi.
Djemtë e vajzat si stëralle
janë male, përmbi male!

Në kuadrin e festës së çlirimit të Kurveleshit, i përulemi kujtimit të dëshmorëve dhe sakrificave të partizanëve, që na sollën lirinë.

KUR VLERËSOHET NJERIU I PUNËS NASE ABAZI



Nga: Ahmet Demaj

Ju falenderoj që të dielën që është ditë e familjes Ju e vutë në dispozicion të personazhit z. Nase Abazit dhe shoqatës “Labëria” që sot mendoi ta nderoi me “Çertifikatën e Mirënjohjes së Labërisë”. Pyetja e parë që shtrohet: Pse? Çfarë ka bërë? Kush ka qenë? Etj.

Që të vemi te thelbi i çështjes po ju sjell dy ngjarje.

E para: Aty nga viti 2017 Bashkia Vlorë organizoi aktivitetin “Personazhe të vitit”, 12 persona. Midis tyre edhe një punëtor i ujësjellsit që kur u fol emri i tij, salla e Teatrit e mbushur plo e përplot shpërtheu në duartrokitje që nuk i mori asnjë edhe pse ishin kuadro të nderuar të qytetit.

E dyta: për vitin 2023 kryetar i Bashkisë aktuale Vlore z. Dredha nderon si personazh të vitit një punëtor gjelbërimi. E thërret në podium, thot fjalët më të mira për të dhe i jep mikrofonin. Çfarë tha kjo punëtor: “Unë nuk e di çfarë kam bërë, por punën që më kanë ngarkuar e bëj mirë. E bëj mirë sepse punën e dua,” Duartrokitje.

Kërkoja të gjeja filozofinë e këtij veprimi. Më erdhi në ndihmë një shkrim gazete e të madhit Dritero Agolli. Tregonte për një bari në Dibër që kishte nja 30 dele të shëndetshme, d.m.th. që nuk u ishte rjepur lëkura, të pastra, d.m.th. nuk ishin të lyera me baltë sepse stalla ishte e shtruar që kishte secila qengjin e vet, dhe të gjitha bashk kishin 5 këmbor që kombinonin si një orkestër. E krahasova me një tufë 150 krerëshe që nuk doje ti hidhje syt për keqtrajtim.

Kush e bënte diferencën e dy pamjeve: “Ishte, thoshte Agolli, KULTURA E PUNËS së barinjve”.

E tillë është jeta jo të gjithë me pozita, me grada e detyra të larta.

E rëndësishme kudo e në çdo punë ta bësh me dashuri dhe të demostrososh kulturë profesionale.

Opinionin publik të regjistron se cili ke qenë, ku ke qenë dhe në fund të jetës të vë notën “Çfarë lë pas”.

Jo të gjithë që ndahen nga jeta na krijohet mundësia ti nderojmë në këto lartësi. Nuk na u lutën fëmijët siç ndodh me të tjerë. Përkundrazi ishin grupe shoqërore, përfaqësues të pushtetit vendor etj organizma që na drejtuan kërkesën. E zgjatëm gati një vit për të krijuar një bindje e për të marrë opinione nga shumë të tjerë. Bëmë mirë sepse sot jemi të bindur nga një pjesëmarrje kaq e gjerë. Nga konsideratat që kemi dëgjuar gjatë këtyre ditëve nga bshkëohësit e tij.

Nuk ka rendësi profesioni, bujk a blegtor, në fushë apo në mal, në zyrë apo në terren. Kudo që ju besua dhe kudo që Nase Abazi ju besua punës, i doli zot asaj dhe krijoi modelin pozitiv për ta ndjekur nga të tjerët. Shkolla, ushtria, kooperativa

detyra që të lejonin këto hapsira ishin angazhimet e Nases dhe ndryshimi nga të tjerët. Qe besnik i fjalës dhe i dashuruar pas punës. Këto bënë që ndihej i respektuar nga rrethi fisnor, nga fshati e më gjerë.

Në detyrat si anëtar Këshilli, brigadier, arkëtar, normist, ekonomist e deri kryetar këshilli. Nuk doli dufiqit,



nuk u gjykua për hatere, nuk ju kthyen vendimet e marra sepse kishte drejtësi.

Nuk të ndjek njeri mbrapa në qoftë se nuk demonstron aftësi, respekt e dashuri që nga më të afërmit e deri më tej. Familja për Nasen ishte modeli që sakrifiko për të dhe mori prej saj respektin e kryefamiljarit.

Aty ai tregoi dhe mori prej saj vlerat e tij njerëzore dhe shoqërore.

Të përballoje rritjen e 10 (dhjet) fëmijve në kushtet e fshatit duhesh sakrificë. Kjo nuk i mungoi që fëmijët e tij të diferencoheshin nga të tjerë. Përkundrazi me organizimin dhe vizionin ekonomist i rrinte plot shëndet dhe te 48 nipër e mbesa të ishin të lumturuar me familjet e tyre.

Si gjithë shqiptarët, Labrit, edhe ploçiotët edhe personazhi ynë Nase



Abazaj pas vitit 1990 nuk e humdi toruan, përkundrazi si një ekonomist i mirë demostroi aftësin e njeriut të zot që di të orjentohet të organizohet për të përballuar ekonomin e tregut, me blegtorinë, me tokën, me lëvizjen fshat dhe qytet u përballua me zgjidhje pozitive për të plotësuar nevojat ekonomike të familjes. Arriti deri ne Amerike.

Shpesh herë opinionin publik të gjykon jo çfarë bëre për vete, por çfarë bëre edhe për të tjerët.

Si veprimtar shoqëror ju besua detyra në organizatat e masave dhe këshillave të kohës e doli mirë.

Nuk pati diploma universitare por



bisedonte e diskutonte me të diplomuarit spse kishte vërtetësinë e jetës.

Koha e dalloj nga të tjerët dhe ne për këtë e veçuan nga të tjerët, sepse nuk qe ambicioz



dhe të bëhej problematik për shokët dhe fshatin, përkundrazi demonstronte dashuri, nuk ishte xheloz për arritje të tjerëve, përkundrazi e gëzonte suksesi i shokut dhe mësonte prej tyre.

Kjo mënyrë sjellje ja vleronin si kapital fshati dhe krahina.

Por Ai la dhe dy kapitale të tjera. La pas 10 fëmij dhe dhjetra nipër e mbesa që këto pesë vjet që Nasja është shkëputur nga jeta e kujtojn dhe këtë 5 vjetor më ndryshe duke bërë pronë të tyre Çertifikatën “Mirënjohje e Labërisë”, akorduar nga SH. A. K. “Labëria” “Nderi Kombit”.

Dhe kapitali i dytë: është i lumtur kush vdes kur ka jetuar jetën ndershmerisht “thot në folozof”. Dhe këtë thënie e ktheu në realitet me jetën e tij edhe Nase Osmën Abazaj që ne nderojmë sot.

Pati ovacione duartrokitjesh sepse në nderim të tij kishte gati 100 vet. Në krye bashkëshortja e Nases Pajamja.

Shpesh dhe pa shumë portokoll ju dha fjala ish Kryetarit Bashkisë Selenicë **z. Pëllumb Binaj i cili u shpreh:** Nuk më befason pjesmarrja kaq e madhe sepse njihja Nasen. Njihja punën dhe respektin

që gëzonte jo në Ploç por në krahinë. Njihja punën e tij që kur ja lije në dorë të nderonte. Të nderonte sepse luftonte dhe punonte siç bëjnë gjithë ata që duan të ikin nga kjo botë me emrin “Njeri i ndershëm”. Kjo gjë thoshte Nase Abazi koston shumë pak, resdpekto njerëzit, respekto ligjet e shoqërisë, mos jeto si parazit dhe të tërë të

nderojnë.

Sot se kemi këtu, por kur shohim prezentë 10 fëmijët e tij dhe kaq shumë nipër dhe mbesa themi me gjith mend ata janë të Nases, por janë ploçjot, janë labër, janë shqiptar. Të mësojn ata e ato që bëjnë nga një fëmijë se nuk ka vështirësi që nuk kapëcehet. Këtë e realizojnë ata që e duan vendlindjen. Po ne kemi nevojë më shumë edhe për njerëz.

Fatmir Abazi, dr. i Z.V.A. Selenicë që ishte rritur afër Nase Abazit solli kujtime të fëmijërisë së tij që nxirrte figurën e Nase Abazit të dashur të urtë por shumë kërkues për sjellje e norma brenda familjes, brenda fisit dhe shoqërisë.

Albert Habazaj e trajtoi fjalën e tij paralelisht dhe vertikalisht. Në secilin këndvështrim Nasja edhe pse nuk është sot me ne na lëshon dritë me modelin prindëror që na la.

FLORIAN BINAJ (humorist i portokallisë) që ishte edhe nip i Nase Abazit deshi të rrinte në hije andej nga fundi. E ftuam të jepte një emocion për aktivitetin dhe për dajën e vet. Kam qenë i vogël kur vija me babin tim te dajo Nasja. Kam kujtimet më të bukura të fëmijënisë për dajon për Ploçën për qytetin e Amantia. Por ju them sinqerisht se ky aktivitet më bëri ta dua dajo Nasen në qiellin ku është edhe më shumë dhe të rrit respektin për SH. A. K. Labëria. Ju falenderoj.

Mbesa e Nases që nuk ja shënuam dot emrin recitoi një poezi me 15 strofa – krijoi emocione të tilla që ndonjëri derdhi edhe lot. E tillë qe motra e Nases martuar në Brataj znj.Nikaj. Ja pak vargje të kësaj poezie:

*Në mungon shumë ajo kohë
Kurr su lodhe duke pritur
Sakrificë të shkoi gjithë jeta
Për të vegjël e të rritur.*

*Sot nuk je midis nesh
Se jeta kështu e ka
Me fat kush të pati djalë
Me fat si babë e vëlla.*

*Sot për ty jemi mbledhur
Me shok e miq rrethuar
Ti nga lart na buzëqesh
Siç ne ishim të mësuar.*

Erdhi momenti i dorëzimit të Çertifikatës. U thirr djali i tij, i cili mes emocioneve të tij emocionoj gjithë të tjerët. Nuk e pandehja që do të vinte një ditë për ta kujtuar babain tim me kaq shumë miq e shokë dhe me këtë nderim kaq të lartë. Ju falnderoi.

Gjith aktiviteti arriti në atë pikë të shpërthimit të këngës nga grupi polifonik i Sevasterit. Fotografia të shumta e me plot mall. GËZUAR ME NJË GOT VERË u mbyll për të lënë mbresa se kur vlerësimet që bën Labëria kanë vlera reale ato ngrënë autoritetin e punës sonë.

NDERIM DHE RESPEKT PER ISH REPARTIN E BATALIONIT TE ZBULIMIT AUTONOM SPECIAL 4356 DRAGOT TEPELENË!



Nga: Xhenet Sula

Reth viteve 66-67 ky repart u ndërtua në Manastir, buzë lumit Vjosë përballë fshatit Dragot rrëzë malit Golik, 6-7 kilometra larg qytetit të Tepelenës, poshtë së cilit bashkohen tre lumenjtë, Vjosa-Drino dhe Bënça. Për tre dekada rresht në këtë repart u stërvitën me qindra e mijëra urshitarë aktiv e oficerë, duke lënë gjurmë përmes tri gjërave të rëndësishme: e para edukoi dhe formoi, e dyta bëri gjithçka dhe realizoi e la vepër mbreslënëse dhe së treti, në heshtje e pa bujë, ai kultivoi jo vetëm te ushtarku por edhe në komunitet respektin për njerëzit dhe dashurinë për atdheun. Veç tyre ky repart special stërviti e mësoi rezervistët nga forcat vullnetare e forcat e lira, Shkollën e Mesme Dragot, nxënësit e Gjimnazit "Asim Zeneli", të Pedagogjikes dhe studentët e Universitetit "E Çabej"! Në ç' do garë të zhvilluar në Tiranë sot (*Kompleksi Partizani*) ky repart gjithmonë ka zënë vendin e parë midis 9-Korpuseve e Divizioneve që nga vitet 1968-1971-1974-1978-1980-1983-1985-1986-1988-1989-1993 dhe 1994, tregon ish komandanti i këtij reparti zoti Seit Tahullai dhe ish shefi i shtabit Vladimir Bullari. Dhe për këto arritje ai shkroi emrin me gërma të arta në stendën e varur përkrah reparteve më të mirë në Ministrinë e Mbrojtjes. Veç tyre ky repart special njësoi rezervistin me ushtarin aktiv, arritje kjo e cila u pa gjatë një mësimi tregues i zhvilluar më 5 qershor 1989 buzë lumit Vjosa në Dragot ku merrnin pjesë reparte nga i gjithë vendi dhe ish udhëheqja e Qeverisë e Shtabi i Përgjithshëm i asaj kohe, ku gjatë demonstrimit rezervisti nuk dallohej nga ushtari aktiv. E po kështu edhe qershorin e vitit 1994 përsëri ky repart i disiplinuar e aktiv do të çudiste Amerikanët (një grup ushtarakësh) gjatë një mësimi tregues ku panë se si ushtari veshur me uniformë dhe paimet komplet me automatikun hedhur krahu qafë i lidhur pas një filli peri, fluturonte në ajër duke zbritur me shpejtësi drejt tokës i pa siguruar e pa masa mbrojtëse... të habitur ata u shprehën se as tek në kjo nuk realizohet... gjithçka perfekte veç mungesës së komunikimit me radio.. (ndërlidhjes)! Sot ky "njehësohet" me trupat Elite Speciale të M.M e Forcat Operacionale të Ministrisë së Brendshme. Te ky repart janë dalluar: në ski Piro Kumbulla nga Pogradeci, kurse në stërvitje komplekse Xhelal Tagani nga Tirana, Aqif Haka nga Elbasani e Demir Suli nga Kuçova si dhe Sami Ruçi, Agron Shehu, Ilir Bregu, Kastriot Lusha, Edmond

Shehu, Malo Sina, Nuredin Halili e autori i këtij shkrimi nga Tepelena si dhe Fejzo Fejzaj, Fatmir Mema Thoma Peri e mjaft të tjerë nga Memaliajt dhe Vasil Naçi në hekur e paralele nga Finiqi i Sarandës e shumë të tjerë të cilëve u kërkoj mirëkuptimin tim për mospërmendje të emrit. Komandant i parë i këtij reparti ka qenë Pashk Simoni nga Rësheni, Seit Tahullai nga Erseka, Shpëtim Spahia nga Përmeti, Abas Pasha nga Tepelena, Jorgo Qirko nga Gjirokastra, Vladimir Bullari Kuçovë e Koco Manxhari nga Gjirokastra. Ndërsa komisar i parë ka qenë i nderuari Fejzo Progonati nga Tepelena, Bari Korça nga Pogradeci, Agim Golemi nga Gjirokastra dhe Dhimitër Mekshi nga Zagoria. Shef shtabi Ded Ndreu, Hariz Mysja nga Shijaku, +++ Barjam Kanani nga Tepelena, Rrapo Hazisi nga Skarapari, Vladimir Bullari nga Kuçova, Kamber Hoxha nga Tepelena e Koço Manxhari nga Gjirokastra. K/ kompanie kanë qenë: Haris Misja (Gjirokastër), Lifto Guga (Tepelenë), Agim Bendo (Gjirokastra), Dilaver Miharremi (Kolonja), Hysen Sharra, Azem Hyka si dhe Ilir Puja i cili sot është Gjeneral Brigade dhe përfaqësuesi ynë në Shtabin e Natos Bruksel. Instruktorë kanë qenë: Vasil Stamuli nga Derviciani inxhinier specilaist alpinizmi dhe Mjeshtër Sporti, Agron Skënduli nga Gjirokastra



instruktor sampo dhe i ndjeri Tigër Godo nga Delvina. Ndërsa shef zbulimi ish Memo Gjoka nga Tërbaçi Vlorë dhe Irakli Ahmataj (Fier). Dëshmi e këtij reparti special është dhe "Dokumentari i Mezhgoranit" i cili na sjell pamje reale se si ushtari aktiv arrin e thyen tullën me dorë..., e më pas realizon hedhjen e lirë me kokë nga lartësia e Urës së Dragotit drejt lumit Vjosa, jetesën në shpellën e Mezhgoranit si dhe zbritja e ngjitja alpine në faqen e shkëmbit të Shpella e Peshtanit (Saimol). I nisur si një nënrepart i vogël si pjesë e Dedashmentit të Zbulimit F.A. Zall Herr Tiranë në vartësi të Korpusit Gjirokastër në vitin 1972 ai u kompletua në Repart Batalion Zbulimi Special, si pjesë e Korpusit Gjirokastër. Ky repart kishte: Fjetoren model e cila shkëlqente si brenda dhe jashtë nga pastërtëia...! Gjithashtu furrën e bukës, guzhinën e gatimit dhe mención, si dhe ujë 24 orë! Me ekonomi i cili mbante të imta dhe prodhonte perime... Po kështu dhe 7-depo nga të cilat: dy me veshmbathje dy me ushqime, dy armatimi dhe një me dinamit, të cilat mirëmbaheshin nën kujdesin e të nderuarit n/officer Hasim Dema, para tij ish Gjolek Deda, si dhe klasën mësimore, bibliotekën pasuruar me libra, sallën e mbeldhjeve dhe komandën! Ish instruktori 82 vjeçar Agron Skënduli



Repart i 4356 Dragot Tepelenë në Jugun e Shqipërisë ka qenë padyshim një shkollë e vërtetë e artit ushtarak, gjurmët e të cilit mbetën të skalitura në memorien e shumkujt si një universitet. Nderim, respekt dhe mirënjohje për ç'ka ka bërë ky repart në Jugun e Shqipërisë!

tregon se ky repart ka qenë një Akademi me dy poligone, njerin stërvitje e tjetri për qitje, plus poligonin e brezit ajror mbi 15 metra të lartë ndëtuar mes rrepeve 170 metra të gjatë i cili gjallonte buzë lumit Vjosa. Qytetin sportiv të kompletuar me paralele e hekur, kullën 13 m të lartë e shkallë suedeze, litarin, unazat, kalimin e pengesave dhe gropën ujore, transhetë e traun e ekuilibrit, kaluçët, gerrat tavolinën me susta, shtangat jastëk e thasë grushti, mbushur me rërë sallën e boksit dhe te mundjes kmpletuar me dushekët, pajisjet e dyluftimeve, vendin e përgatitjes për alpinizëm, komardare 6 ...vendëshe për kalimin e lumit në dimër apo det, thika e mjete maskimi, skafanda e shkallë ngjitëse... mbyll rrefimin instruktori! Kurse Vladimir Bullari dhe ky ish komandat për këtë repart shprehet se ai ka qenë një Universitet! Gjatë vitit ushtari i zbulimit vishej 8-muaj me uniformë, nga këta 5 me



verore 3 dimërore e 4-muj rrinte me uniformë sportive nga maj-korrik, buzë Vjosës si dhe gushtin në Bunec pranë detit Jon. Gjatë dy fushimeve (*stërvitjet dimërore dhe ato verore*) ushtarët aktivë çdo vit stëviteshin në Çajup deri dy muaj janar-shkurt. Ndërtohej fushimi, ngriheshin çadrat brenda të cilave flinin ushtarët dhe pse temperaturat binin nën -15 gradë celcius...natën plus jetesa në guva me dëborë. Gjithashtu kryheshin disa marshime për kapjen e lartësive Strafec e Strakavec, si dhe një marshim ku zgjaste 6 orë i cili niste nga vila e ish Petrit Dumes-Çajup-Hije Mallkuar-Zhej-Oshtev e maja e malit Dhëmbel ku dalloheshin dritat e qytetit të Përmetit dhe kthim nëpër natën e zezë të muajit shkurt në orën 3 të mengjesit. Kurse për të kryer ski do ecje 1 orë e 45' në këmbë derisa arrije te stanet e "Asim

Zeneli" vendi ku zhvillohej stërvitja 4 orë çdo ditë nga mesi e lart zhveshur, duke u lëshuar nga një pjerrësi 180 gradë. Ndërsa në Bratë zhvillohej qitja e tek Shpella e Kuqe bëhej alpinizëm. Në fund stërvitja mbyllej me një mësim tregues e cila jepej në fushën e Çajupit edhe pse qe pjesë- pjesë e mbushur me ujë. Çdo të premtë-të dielë vinin me radhë nga dy klasa të Gjimnazit "Asim Zeneli" e Pedagogjika si dhe nga 5-7 ditë studentët e Universitetit "E Çabej" plus rezervistët si nga Dragoti, Mezhgorani e Peshtani, Luzati Hormova e Tepelena... Saranda Delvina, Përmeti, Fieri e Berati... Kthimi në këmbë Çajup-Hormovë-Repart si dhe nisja. Fushimin veror repartit e kryente në muajin gusht në Bunec (Sarandë). Stërvitja fillonte me vrapin, sampon e

notin, kalimin e pengesave dhe dyluftimet trup me trup, boks e mundje, si dhe krosin e Lukovës me çantën pas shpine të mbushur me rërë duke u nisur nga Buneci taracë më taracë deri ne majën e Kodër-Lukov e anasjelltas dhe në fund mbyllej me mësimin tregues i cili zhvillohej në qendër të Piqerasit! Fushimi ngrihej larg detit 35 metra dhe jetesa bëhej në çadra. Në përfundim kthimi në këmbë Bunec-Sasaj-Kalas-Kardhiq-Repart e mbyll rrefimin e tij Vladimiri! Ky repart shkante edhe një muaj në Drilon Pogradec në ruajtje të udhëheqjes. Gjatë përgatitjes ushtari aktiv bënte një herë në muaj vrapim: Repart-Lekël-Hormovë-Subash kthim e unazën çdo dy muaj nisur: Repart-Dragot-Ura e Ali Pashës-Luzat-Lekël-Repart 17 km 800m, çdo mëngjes nga ora 5-6 repart-ura e Leklit e kthim, tre herë në javë çdo mbasdite, Dragot -Saimol- Dragot-Beqisht e kthim. Ndërsa krosin 5-kilometërsh me komplet paimet :repart-Kodër-Lekël e kthim e bënte 33 minuta monitoruar nga komisioni i M.M. me kronometër! Veç tyre mbulonte me shërbime: Korpusin, tunelin Mezhgoran (Spitalin), Shtëpinë e Oficerëve Gjirokastër, si dhe Vrojtimin Pamor-Optik në pikat: Radat - Leskovik, Bureto-Libohovë e Likojan-Konispol. Ka demonstruar e dhënë Mësim Tregues para popullit: në Tepelenë e Progonat, Gjirokastër e Lukovë, Piqeras e Dragot... si dhe para udhëheqësve kryesorë të ushtrisë dhe Qeverisë... Veç tyre repartit ka patur marrëdhënie shumë të mira me komunitetin, ku bëheshin aktivitete kulturore -sportive të vazhdueshme, për të cilat është folë e shkruar dhe falënderuar si nga autoritetet vendore e ushtarake e po ashtu edhe nga ato qeveritare ku është vlerësuar me certifikatë, medalje e tituj nderi dhe dekoruar nga ish Presidiumi i Kuvendit Popullor! Por nderimin më të madh këtij repartit autonom special ia kanë dhënë ata qindra e mijëra ushtarë e rezervistë... nga Jugu e Veriu të cilët me këmbët e tyre sollën në trupit e tij ato qindra suksese normat e të cilave u futën përgjithmonë në të gjithë ushtrinë." Po përtej saj repartit 4356 Dragot Tepelenë në Jugun e Shqipërisë ka qenë padyshim një shkollë e vërtetë e artit ushtarak, gjurmët e të cilit mbetën të skalitura në memorien e shumkujt si një universitet. Nderim, respekt dhe mirënjohje për ç'ka ka bërë ky repart në Jugun e Shqipërisë!

GJASHTË SHENJTORË BEKTASHI TË FUSHËBARDHËS

(Në nderim të burrave të ndritur dhe të ditur të Labërisë dhe Bektashizmës që lindën në Fushëbardhë, që i dhanë dritë e mirësi njerëzisë dhe që vijojnë t'i japin nur e dritë, që sollën abetaret e para shqipe në Fushëbardhë dhe në krahinën e Kardhiqit dhe Rrëzomës, për ata që Atdeun dhe flamurin e kishin nënë e babë falë devizës së tyre të famshme "Pa Atdeun nuk ka Fe". Mirënjohje dhe nderim për ata që ishin drita e ndriçimit me dije e mirësi njerëzore, që përveç riteve bektashiane kishin rol patriotik, atdhetar aq të nevojshme për Labërinë dhe jo vetëm, që ishin pishtarë të ndriçimit të ndërgjegjes por dhe mjaft arsimdashës, për Devish Mehmet Golemi, Baba Pëllumb Veliu, Dervish Myftar Ago Golemi, Dervish Lutfi Meçe, Dervish Lutfi Kondi dhe Dervish Mikel Maksi Onjea, për ata që me të drejtë populli i quan atdhetarë shenjtorë)



Nga: Prof. Asoc. Dr. Zaho GOLEMI

Hulumtim në mistikën bektashiane në Labëri

Duke hulumtuar në gojëdhënën mistike popullore thellë në histori të Fushëbardhës, Fushëvërrisë, Zhulatis, Kardhiqit, Plesatit, dhe sidomos dy krahinave që takohen në Qafë të Skërficës Krahinës së Kardhiqit dhe asaj të Rrëzomës gjejmë të dhëna nga më interesantet edhe për çështjet e besimit, të trashëgimisë, të së drejtës, të kanuneve e sharteve, të së drejtës zakonore e kanunore, parashtetërore e pashtetërore dhe mbi të gjitha të udhëheqësve shpirtërorë të bektashizmës. Përtej të dhënës së trashëgueshme burimore gojore qëndron ajo arkivore si dhe librat, gazetatat, revistat, që ndeshin me Zhulatin e Fushëbardhën, me rregjistikimet e para, me emërtimet e para, me besimet e para, me fiset Nik, Pal, Pani, Zaho, Zhulaj, Kondi, Veliu, Kosta, Guma, Dhima, Bogdani, Bidër, Gjoni, Gjonmadhi, Lalëgjoni, Sinanagaraj, Sinanaliaj etj., por dhe fise të tjerë me mbiemra të thellë ilirike, si; Gjok, Gjin, Gjeçi, Gjoça, Peçi, Basho, Kuçi, Gjokoli, Kuci dhe dhjetra të tjerë që kanë marrë emërtime sipas periudhave që ka jetuar Kaonia shekujve. Bijtë e dy krahinave Kardhiq dhe Rrëzomë ishin bashkë në jetë e bashkëjetesë, por edhe një pjesë e vogël dhe në karrierë administrative, por më shumë karrierë ushtarake duke filluar nga spahinj, agallarë, bejlerë, subashë, sanxhakbej, si dhe grada të tjera ushtarake që Kaonia e kishte për zemër. Fillimisht bektashizmi kishte filluar me "dervishë shëtitës" në Shqipëri. Bektashianët e parë kishin filluar me besimin e tyre të tërhiqin besimtarë të shumtë që nisin me Ali Horosanin/Sari Sëlltëkun, i cili aktivitetin e parë e kreu në Krujë, Dylgjer Hyseini

në Elbasan, dhe Arshi Babai në Gjirokastër. Populli i pëlqeu dervishët shëtitës/kalander të besimit bektashi, prandaj edhe u përkrahën për mençurinë, besimin, tolerancën dhe mbi të gjitha për kundërshtinë ndaj rregjimit pushtues osman. Me këtë rast u ndërtuan edhe teqetë, sikurse ishte në Gjirokastër e mirënjohura Teqeja e Zallit nga nipi i baba Arshiut, dhe më tej ajo e Shtufit, e Hazmuratit nga Baba Zeneli që u pasuan nga ajo e baba Sulejmanit në Kardhiq, baba Hasanit në Zhulat. Është i njohur kontributi i teqesë së baba Hasanit në Zhulat ku veç të tjerash kishte mejtep, ku mësonin shkrim e këndim, me bibliotekë teologjike, ku kishte edhe strehore për nxënësit që vinin nga fshatrat e tjerë. Këtu kanë mësuar edhe disa dervishë nga Fushëbardha dhe jo vetëm. Mençuria dhe dituria i dalloi dhe i dallon në misionin e tyre të pandryshuar shekujve.

Gjurmë të shquara bektashizmi në Fushëbardhë

Janë të shumtë, të njohur dhe të panjohur shenjtorët që i kanë dhënë shumë shenjterisë dhe atdhetarisë e patriotizmit. Kur shkruajmë për ta ata bëhen edhe më të pavdekshëm, pasi kush kujtohet nuk harrohet kurrë. Baba Pëllumb Veliu ishte nga Fushëbardha dhe ka qenë dervish në Teqenë e Kajros në Egjipt. Atje ishte dorëzuar edhe dervish ndoshta pas kryerjes së shërbimit ushtarak shtetë vjeçar të kohës së Perandorisë Osmane. Fakt është se në Kajro ka shërbyer edhe një Dervish tjetër nga Fushëbardha Baba Lutfi Meçe. Fakt është që sipas dervish Mikelit pas mbylljes së teqesë së Kajros pas vdekjes së babait të fundit Baba Siri Çoçolit nga Glina e Leskovikut baballarët dhe dervishët e kësaj teqeje shkuan në teqenë e Baba Rexhepirt në Michigan të Detroitit dhe janë varrosur në varrezat e qytetit dhe kanë tek koka një pllakatë të kuqërremtë graniti që shkruhet edhe Kleri Bektashi. Mbiemri Veli thoshin të vjetrit e morën nga domethënia "i shenjter", ndërkohë që më parë duan të thonë që llagapin e kishin "Matushi". Dervish Pëllumbi nga Egjipti shkoi në Turbanlli Sulltan Baba në Farsallë të Greqisë atje ku është bërë beteja e famshme e Farsallës që studjohet në të

gjitha Akademitë ushtarake të botës. Prej Farsallës erdhi për pak kohë në Fushëkrujë në teqenë e Shememi Babait, pasi kishte njohje që në Kajro me Haxhi Ismail Baba. Kjo teqe vizitohej shpesh nga besimtarë bektashinj nga Fushëbardha, Krahina e Kardhiqit dhe Rrëzomës. Pleqtë e moçëm e mbanin mend baba Pëllumb Velion për mirësitë dhe mbështetjen e madhe që u jepte fshatrave të rrëzomës si shërues,

dorëzuan gradat, uniformën dhe armët dhe u dorëzuan dervishë tek Ahmet Shkodra. Por ngaqë ishte bektashi Lutfo Kondi i qëndroi besnik Bektashizmit dhe besëlidhjen e mbajti deri në fund të jetës edhe pse më 1967 besimet në Shqipëri u ndaluan me ligj. Dervish Lutfi Kondi prehet në varrezat e Gjirokastrës. Ndërkohë që kemi një shenjtor të ri të Bektashizmës Dervish Mikel Maksi Onjea, që është nderi

Shkurtimi i emrave ishte dhe është praktikë në Labëri dhe jo vetëm. Dervish Myftari lindi në Fushëbardhë në vitin 1869 dhe ishte njeri me intelekt të madh. Shkollën fillore "Meltepen" e kreu në Zhulatin e Përtejme, sikurse i thoshin njeri tjetrit Zhulati i këtejme për Fushëbardhën dhe Zhulati i përtejme për Zhulatin. Ai u përzgjedh nga zotësia e urtësia dhe u dërgua në Turqi për studime teologjike në Stamboll. Atje kreu shkollën e mesme fetare për 4 vjet, kthehet në në Atdeun dërgohet në Teqen e Baba Brahimit i shërbeu popullit për 24 vjet shoqëronte besimtarët e Babait të Teqesë në Teqenë e Shtufit. Më vonë transferohet në Teqen e Baba Zenelit në Gjirokastërku shërbeu deri në fillim të nëntorit 1956. Në këtë periudhë sëmuret dhe dërgohet për kurim në spitalin e Sanatoriumit të Tiranës. Por për të edhe pleqëria bënte të vetën. Më 12.11.1956 në Kryegjyshatën e Tiranës kishin shkuar nga Fushëbardha për ta takuar dhe çmalluar, pasi koha e vrullshme i dërgonte njerëzit nga njeri skaj në tjetrin, megjithëse vetë kishte deklaruar se, "mbase nuk takohemi më bashkë. Sëmundja nuk më lë të ngre kokë. Fliste dhe shikonte një sahat xhepi, që shkëlqente si flori...". Në takim jepte urata dhe përfaqime. Fakt është se në fund të muajit nëntor 1956 Dervish Tarua u nda nga jeta në moshën 87 vjeçare. Nga të dhënat e Kryegjyshatës së Tiranës, atij ju bënë të gjitha



Njeriu i Shenjtë Pëllumb Veliu

si zgjidhës i halleve e deri në gjetjen e ujit të pishëm dhe për vaditje në fshatrat e Rrëzomës, që me shkopin e tij trokiste saktësisht ku të gërmohej dhe të nxirrej ujë, aq të domosdoshëm për jetën. Ka pasur edhe një tendencë për tu bërë dervish dhe Shuko Veliu (rrezultat i ndikimit të shërbimit tek Baba Pëllumb Veliu), por nuk u realizua nga kushtet e reja politike që u krijuan në mesin e shek XX. Në Shqipëri. Dervish Lutfi Kondi ka qenë bektashi nga familja e tij, por fillimisht ka qenë ushtarak në periudhën e Mbretërisë. Ai ishte njohur me Sheh Ahmet Shkodrën i cili ishte sheh i tarikatit Rufai dhe profesor që jepte mësim në Universitetin Haxhi Sheh Shamia të Shkodrës. Është fakt se Lutfi Kondi pasi pa një qeramet mbrekulli të sheh Ahmetit bashkë me një koleg ushtarak nga Vlora (Kodhel Zilja),

dhe krenaria e Fushëbardhës, Krahinës së Kardhiqit, Rrëzomës, sidomos Teqesë së Turanit, që e ka ngritur e stolitur vetë në më pak se një dekadë. E veçanta e këtij djali dervish që punon me pasion është fryt se e ka përgatitur vetë Haxhi Dede Reshat Bardhi, shenjtori i madh që e ringriti Kryegjyshatën kur ishte burgosur për më shumë se dy dekada. Nuk është e rastit që thesarët e trashëgimisë botërore si Ciceroni thoshte: "Nuk duhet vajtuar vdekja, për ata që pas i ndjek pavdekësia". Pavdekësia është një vlerë e rëndësishme e përbotshme, rrezatuese në mirësi për njerëzimin.

Një varr për prehje për simbolin e mirësisë njerëzore

Dervish Myftari, që në popull thirrej thjeshtë "Dervish Tarua".

nderet sipas riteve të baktashinjve, por varrimi i tij thuhet se është në varrezat e lagjes së "Varrit të Bamit". Këto varreza janë hequr rreth 10-15 vjet më vonë sepse vendi i quajtur "Varri i Bamit" u bë një lagje e re me pallate dhe u quajt "Xhamllëku i ri". Pushteti qendror e vendor i kohës njoftoi në këtë periudhë për heqjen e varrezave të "Varrit të Bamit" dhe vendosjen e tyre në varrezat publike të Tufinës dhe të Sharrës në Tiranë si dhe për t'i marrë të afërmit pranë vendbanimeve të tyre. Në këtë periudhë ende nuk ishin hequr me ligj besimet dhe institucionet e kultit. Por mungesa e komunikimit, largësia dhe varfëria krijonte problem. Dua të shtoj këtu edhe një tërheqje të imponuar të njerëzve duke u larguar me hir apo me pahir nga besimet.

Kur ulem e shkruaj për Prof, Dr. Ago Nezha, “Mjeshtër i Madh”



Nga: Pandeli Bardhi

Jam i bindur, që asnjëherë nuk do t ja arrij qëllimit dhe kjo, për të vetmen arsye, që është e pamundur që të trajtoj të gjitha zhanret e tij në të gjitha fushat, me atë seriozitet që i ka trajtuar Professor Ago. Sigurisht, ka edhe të tjerë krijues në disa fusha, si të them, që prekin “pak nga të gjitha” por mes atyre, ata kanë një apo dy më kryesoret, kurse vecoria e Professor Agos, është pasioni i tij për t'i dhënë të gjitha krijimeve të tij rëndësinë që i takon

Professor Ago Nezha, ka përfunduar studimet e larta, për agronomi dhe nuk është vetëm një agronom që ka futur shkencën dhe eksperiencën e përparuar në prodhimin bujqësor, me studimet dhe krijimet e tij në fushën e rritjes së prodhimit duke zbatuar metodat shkencore, por po kaq shkencor, është edhe në krijimet e tij si shkrimtar, si poet, si publicist, si historian, si mjeshtër i skicave humoristike dhe i tregimeve,, si mjeshtër i portreteve dhe i aktrimeve, si mjeshtër në Monografi dhe kinematografi etj..

Aftësia e tij është që të gjitha këto, i ka mbledhur brënda vehtes dhe të gjithave u a ka gjetur “midenë”, i ka bërë “aleatë” dhe ato, kanë gjetur “consensusin” dhe janë “bindur” që vetëm tek Ago Nezha, ato zënë vendin që i takon, trajtimin e tyre me mjeshtëri, artistike, me gjuhën e thjeshtë e të kuptueshme nga të gjithë. Ja, për të gjitha këto, për mua, është e pamundur” që t'i trajtoj të gjitha ashtu si duhet në mënyrë që asnjëherë të mos “imbetet hatri”, e megjithatë unë do të mundohem që aq sa të mund do të nxjer në pah atë punë të gjithanshme që ka bërë dhe bën ky intelektual në punën e tij krijuese, duke qënë i bindur që ndonjëra prej tyre, si poezia, tregimi, proza, artikujt publicistikë apo shkencorë etj edhe do të më “zëmërohen”!

Me të drejtë Prof. Dr. Et-hem Ruka, në parathënien e Librit të tij, “Shqipëria dhe Krahinomania shkruan: “Truri tij, është një “Laborator” që ka prodhuar pa pushim, ditë pas dite, muaj pas muaji dhe vit pas viti..Në këtë rrugëtim jo të lehtë që kap Dekada të tëra, dora dhe mëndja e tij nuk kanë bërë dhe vazhdojnë të mos bëjnë pushim.”Aktiviteti i tij është i gjithanshëm dhe i përket të gjitha fushave sic shkruan edhe i Madhi Dritëro Agolli tek i drejtohet me fjalët: “Agos, mikut tim të shumëcuar dhe publicist të shquar e të nderuar që ka energji të pashtershme dhe shkruan parreshtur në prozë, poezi e publicistikë, me frymë të rreptë kritike”!

Shkurt, Ago Nezha, është një intelektual i kompletuar që mban të gjitha “celsat” e dijes të cilat nuk i ka mbajtur “pronë” të tij, por i ka përdorur për t'i ndricuar rrugën, brezave të sotëm dhe atyre që do të vijnë.

Vëndlindja e tij, Dukati, ka qënë frymëimi i tij qysh në krijimet e para të adoleshencës, në fillimet e viteve të para të shkollës. Duke mos patur mbështetje për të vazhduar me krijimtarinë e tij, vazhdoi shkollën e Mesme Bujqësore, në përfundim të së cilës punoi për pesë vite si agronom në Kocul të Vlorës. Mer pjesë në konkursin për aktrim dhe zë vëndin e parë, duke dhënë përsëri prova për të vazhduar në Institutin Arteve por Kryeministri i kohës Mehmet Shehu, mes të tjerave u shpreh: “Përpara se të merremi me artin, kemi nevojë për bukë.”! Kaq u desh që Ago nezha më pas të vazhdonte Universitetin në Degën e agronomisë. në vitin 1966-1971.

Pas përfundimeve të studimeve në Agronomi ka mbaruar me korrespondencë dhe dy fakultete të tjera, Ekonomikun, ku dhe ka doktoruar, që ka marrë gradën doktor dhe titullin profesor dhe Filozofinë, që e kishte pasion. U dërgua në Ndërmarrjen Bujqësore të Thumanës, rrethi i Krutës për të bërë stazhin një vit në prodhim, pasi ishte kusht për të punuar në dikastere qendrore. Pasi mbylli vitin e stazhit me rezultate të larta në prodhim, nuk u lejua të vinte në Ministrinë e Bujqësisë, pasi Komiteti i Partisë Rrethit Krutë e emëroi Sekretar të Parë të Rinisë së Rrethit ku punoi për katër vjet. Pastaj u mor në Komitet Qendror të Rinisë ku punoi nga 1976 deri 1980 dhe pas një xhirimi në këto vende, kur iku nga Komiteti Qendror i Rinisë ju afruan disa variante në detyra të larta si në Kontrollin e Shtetit, etj, por ai preferoi sektorin e shtypit dhe u kthye në Ministrinë e Bujqësisë, në detyrën e Shefit të Shtypit dhe Propagandës, që ishte dhe një nga prirjet dhe ëndrrat e tija.ku punoi për shumë vjet si shef e drejtor i Drejtorisë së Informacionit Agrorshqimor, nga viti 1980 e deri në 2010, ku doli në pension të parakohshëm, pasi u shkel statusi Profesorit, nga Ministri i Bujqësisë për motive politike. Me ardhjen e demokracisë dhe pluralizmit në Shqipëri Ai, u angazhua në politikë si krijues i Partisë Agrare dhe shtypit të saj “Progresi Agrar”. Një kontribut të madh ka dhënë në krijimin dhe drejtimin e shoqatave, si të Shoqatës Dukati ashtu dhe të Shoqatës “Labëria” që po e drejton prej 20 vjetësh dhe është arritur që kjo shoqatë të mbajë titullin e lartë “Nderi i Kombit”.

Por, le të kthehemi tek krijimaria e tij.

Si shkrimtar e Poet, Ago Nezha i ka dhënë publikut një sërë veprash si “Balil Nezha, kalorës i trimërisë”, “Sfidat e jetës të Seit Bishnjakut”, “Shoqata Labëria 30 vjet jetë dhe aktivitet”, “Papagajtë e Politikës”. Të ndalemi pak këtu. Gjatë një intervistë në Kananlin tetevizionit Neës 24, pyetjes , “Pse e titulluat kështu këtë Libër, Ago Nezha i përgjigjet: “ Mendova se me futjen në politikë e të rinjve do emancipohesh politika, por ndodhi që të rinjtë imitonin lidrët e partive sa majtas djathtas, dhe politika u bastardua më shumë!

Ky libër ka disa sentenca

-Në demokraci jemi të një mendimi që të mos jemi të një mendimi.

-Politika është një fushë veprimi që kërkon mençuri, talent, kulturë, ndershmëri, përshtatshmëri, figurë të pastër morale, dhe përkushtim, e vision, jo vetëm për të sotmen, por dhe për të

ardhmen.

-Një shoqëri demokratike, është e përparuar ose e prapambetur, në varësi të përdorimit të vlerave në tregun intelektual.

-Padituria është ferr, gjëmb e drizë, që është ngatërruar keq në këmbët e shqiptarëve dhe pushtetarëve.

-Diktaturat i poshtrojnë njerëzit deri në atë shkallë, sa që ata arrijnë të lavdërojnë regjimin, si burim të mirëqënies së tyre.

-Shteti si tutor suprem i së mirës së përbashkët mbron integritetin e qytetarëve të vet, ku autoriteti i tij duhet të jetë unitar, gjithëpërfshirës, Sovran dhe detyruar.

-Kur lexon librat publicistik sheh shumë tema që janë refleksion i situatës politike, ekonomike dhe sociale në vendin tonë. Titujt “Opinionist apo opportunist”, “Kuvëndi na Çmëndi”, “Tituj nderi



Prof.Dr.Ago Nezha

apo turpi”, “Hapën dyert universitetet që prodhojnë analfabet”, Mos vdis sa të bëhet tenderi” për një grua të shtruar në gjëndje të rëndë që nuk operohej se s kishte medikamente se s'ishte bërë tenderi, “Gjana i bëri gjëmën Ruli i vuri rrulin”, që shkatërruan institucionet e bujqësisë, apo “Presidenti Meta dhe sekretar Ylli ikën pa dekoruar dhe kafshët e pyllit”, pasi nuk lanë miq e shok pa dekoruar duke bërë qoka, etj.

Libra të tjerë të tij janë:

“Shtëpia në amfiteatrin e Pemëve”, “Ishim më mirë kur ishim më keq”. “Lot në sytë e Detit”, “Hëna e verbuar”, “Hall me nuse e keq me vjehra”, “Dielli I trdhtuar”, “Lypësi dhe zyrtari”, “Rron gjatë ai që le emër të mirë”, “Dialogoj me diabolikët”, “Demonët e Demokracisë” etj etj, të cilat jo vetëm nuk kanë vënd për koment që janë të të gjitha fushave, por edhe janë vlerësuar nga mjeshttrat e letrave shqiptare nëpërmjet parathënies që u kanë bërë Librave të tij si, Dritëro Agolli, Kryetari I Nderit Akademik Rexhep Qose, Profesor Ksenofon Krisafi, Pullumb Xhufi, Et-hem Ruka

Ago Nezha mes librave të tjerë ka edhe Librin “Shqipëria dhe Krahinomania”, me parathënie të profesor Ethem Rukës. Edhe këtu spikat fenomeni për vendlindjen që ka 20 shkrime për Dukatin, si “Dukati i Dukëve të Dukatit”, Dialogoj me djemtë e dukatit,Dukati i dënuar me 7501, Dukati Sanmarinua shqiptare, “Dukati përplaset me pushtetin, Sazan e Karaburun janë vatanit e mia, e shumë të tjerë. Dukatin, vendlindjen e tij, e quan: “Meka dhe Jeruzalemi, ku jam falur dhe falem gjatë

gjithë rrugëtimin tim jetësor..”!

Emri i Dukatit, është lartësuar nga heroizmi në shekuj i patriotëve të shquar në luftrat për liri Pavarësi e clirim kombëtar dhe prosperitet shoqëror.

Dukatasit, janë dalluar për mëncuri, trimëri e burrëri, besnikëri dhe atdhetari. Ndihej krenar si bir i aij fshati që opinionin i gjërë shoqëror që i përflut dhe i përligj këto cilësi të spikatura të tij.. Në krijimtarinë tme letrare, shumëvjecare e multidimensionale si në poezi publicistikë, tregimtari monografi e kinematografi, etj Dukati ka zënë një vend të vecantë të merituar në mozaikun e botimeve të mija,, shkruan mes të tjerave Autori.

Ai e ushquu shpirtin dhe fantazinë qysh në fëmijëri me këngët, legjendat, baladat dhe historitë e mocme të apedanëve të lirisë

jo vetëm në Labërinë e Vlorës si “Perëndeshë e Pavarësisë por të gjithë Shqipërisë

Në mënyrë të vecantë Prof. Ago Nezha, është marë me diagnozën e shoqërisë shqiptare në vitet e trazuar të tranzicionit. Atë e shqetëson e vërteta që fshihet prapa prapagandës, mungesa e ndershmërisë, paaftësia e administratës, problemet e arësimit, shëndetsisë, bujqësisë, korrupsionit boshllëku intelektual që fshihet pas kostumeve e kollarove, shterpësia shpirtërore kariera e pamerituar, servilizmi etj etj plagë këto somos në këtë periudhë të tranzicionit.

Gjithmonë është pak të shkruash për një personalitet të tillë, si Profesor Ago Nezha, jo vetëm si shkrimtar poet e publicist por edhe si Drejtues i palodhur i

Shoqatës A.K. “Labëria”, e vlerësuar me cmimin e lartë Nderi i Kombit. Shoqata Labëria ka bërë aktivitete që si bën dot shteti siç është shprehur Kryetari i Nderit, Akademiku Rexhep Qosja, dhe Shoqata Labëria është bërë mbarë kombëtare. Ndërsa President Moisiu, në Kuvendin e V-të në Gjirokastrës në përhëndetjen e tij tha se; “Shoqatën Labëria do ta kishin zili çdo parti dhe qeveri”.Shoqata Labëria ka bërë gjashtë Kuvende duke filluar nga Tirana, Vlora, Himara, me tendencë për t'u thënë se Himara është Labëri, madje ka qënë kryeqendra e Labërisë me 52 fshatra.. Shoqata Labëria ka bërë shumë veprimtari, por unë do veçoja më pikantët si denoncimin e “Marrëveshjes së Detit”, takimin në Prishtinë për çështjen e “Gjuhës dhe të emrave”, takimin në Preshevë me 100 gra dhe vajza me emrin Vlora si dhe këtë të fundit për “Isopolifoninë”. Roli dhe puna e kryetarit në jetën e shoqatës ka qënë tepër aktive.

Dy fjalë dhe për krijimtarinë e profesor Agos, që është shumë e pasur dhe e larmishme. Ka botuar pesë vëllime me poezi,”Lot në sytë e detit”, me parathënie të të madhit Dritëro Agollit, “Diell i Tradhëtar” me parathënie të Lirim Dedës, Pse vrapoj”, me parathënie të Petrit Rukës, “Hall me nuse keq me vjehra” me parathënie të Skënder Haskos dhe Hënë e verbuar”, me parathënie të Albert Abazit. Ajo që të bie në sy dhe të befason është se në 5 vëllime me poezi 11 poezi i ka për vendlindjen e tij Dukatin.

Dëshmori Myrte Rexhepi pa dëshmi dëshmori



NGA: PROF. ASOC.
BERNARD ZOTAJ

Familja Rexhepaj nëpër luftëra

Prof. Dr. Bardhosh Gaçe shkruan se në jetën historike dhe tradicionale të Lumit të Vlorës, familja Rexhepaj në Lepenicë dhe në Mavrovë u shqua në luftërat dhe përpjekjet e mëdha për lirinë dhe pavarësinë e atdheut, duke flijuar edhe dëshmorë të saj. Tradita e blegtorisë dhe e zejtarisë, si dhe shpirtit bujar i bën ata një emër të dëgjuar në trevën e Labërisë, duke përcjellë edhe në kohët tona gjurmët e mëdha kombëtare.

Lepenica një fshat plot tradita dhe kulturë shtrihet në rrëzë të malit Qyramënge, midis Bratit dhe Gjormit, ku dallohen shtëpi të gurta dy katëshe, me oborre e pemëtari të bollshme dhe kullotat blegtorale. Përfund këmbëve të saj rrjedh një lumë i bardhë me emrin Shushicës, që pasi dredhon luginën së Lumit të Vlorës bashkohet me Vjosën e derdhet në detin Adriatik. Nga ky reliev i ashpër e malor, ku rrëfimet me humor dhe bëmat legjendare, kanë nxjerrë kryekapedanë të shquar të Labërisë, Familja Rexhepaj hodhi rrënjë në Lepenicë në breza të tërë, por Memo Rexhepi së bashku me vëllanë Myrte Rexhepi u shpërngulën nga vendlindja në pranverën e vitit 1936 dhe u vendosën në kullotat që blenë në fshatin Mavrovë.

Lumi i Vlorës shfaqet përherë si një amfiteatër gjigand në gjirin e Labërisë, nga Drashovica në grykat e thella të Kuçit, atje në Zarel ku zë zanafillën lumi i Kuçit, për t'u bashkuar me lumin e Smokthinës në Brataj dhe lumi merr emrin Shushicë. Lumi dhe njerëzit në shekuj kanë përcjellë mjaft këngë historike, në vargjet e të cilave gjëmojnë si vetëtimat sokëllimat e Gjergj Arianitit që theu taborrët osmanë në jug të Shqipërisë për t'u prerë hovin në pushtimin e tyre ndaj truallit arbëror.

Memo Aliu, njeri ndër të parët e fisit Rexhepaj kishte përcjellë tek Memo Rexhepi dhe Refat Rexhepi bëmat e kapedanëve të Labërisë si: Zenel Gjoleka, Cane Miftar Smokthina, Lulo Abaz Mehmeti, Zoto Mahmuti Smokthina, Selam Hasan Velga, Lilo Qendro, Dule Zoto Smokthina, Ramo Balia, Daut Mavrova, Shako Xhaka, Leskodukajt e Bolones, e mjaft të tjerë, që së bashku me ta kishte luftuar në betejat e ashpra kundër hordhive turke. Stërgjyshit Memo Aliu dhe Memo Rexhepi ishin kalorës të Lirisë dhe Pavarësisë së Atdheut në qiellin e Labërisë. Shpirti i madh atdhetar i tyre, u mekua në breza tek familja Rexhepaj në Lepenicë, duke përcjellë gjer sot dashurinë për Labërinë dhe Atdheun, dashurinë e shenjtë

që nuk do të venit kurrë.

Kapedani Rexhep Memua, i cili së bashku me luftëtarët e shquar popullorë nga Gjormi, Lepenica, Brati, Tërbaçi, Velça, Gumenica, Mavrova, Mesapliku e Kuçi, u derdhën në brigjet e Himarës, në vitin 1878, nën thirrjen e Mustafa Pashë Vlorës dhe Odhise Kasnecit, udhëheqes të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit në Jug të Shqipërisë. Betejat e përgjakshme të luftëtarëve popullorë të Bregut të Detit dhe të Labërisë në shkurt 1878, dëshmojnë qartë se trojet shqiptare në Veri e Jug të vendit janë larë me gjakun e atdhetarisë të bijve të saj. Betejat e ashpra me ushtrinë greke në Lëkurës, tregohen edhe sot në vatrat familjare labe, të cilat janë romane historike dhe brenda tyre shpaloset historia shqiptare. Këto dallgë të ashpra u përplasën dhe në fisin Rexhepaj në fillim të shek. XX dhe në kohën e Pavarësisë Kombëtare, ku midis luftëtarëve labër ishte dhe Memo Rexhepi, si në Kuvendin e Drashovicës, korrik 1911, në përpjekje me ushtrinë xhonturke në Mallakastër e në Tepelenë në verën e vitit 1912.

Fjalët e babait të Kombit "për t'i dalë zot trojeve shqiptare në jug të vendit", ishin të gdhëndura si me daltë në mendjen e luftëtarëve të familjes Rexhepaj. Burrat e Rexhepajve kujtonin luftëtarët e plagosur dhe të rënë dëshmorë në luftën për mbrojtjen e Janinës (1913), në Luftën epepe të Vlorës 1920, si dhe në mbrojtjen e Qeverisë së Nolit, në dhjetor 1924, në Shkallën e Tujanit, në malësinë e Tiranës. Familja Rexhepaj,

"Myrte ishte nga burrat luftëtarë të BrXIIS, plot zjarr e vrull në beteja, në Përmet, Këlcyrë, Sarandë, Himarë, kundër pushtuesve nazistë, në tetor 1944. Mbi të gjitha, ka qenë një luftëtar i guximshëm që u shpëtoi jetën sa e sa shokëve partizanë përballë armikut...", me sinjale të urdhrave të luftimeve, por dhe me furnizimin me municione dhe ushqime të luftëtarëve.


u bë një vatër e rëndësishme e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare në Lumin e Vlorës. Ajo vuri në altarin e lirisë, Hano Rexhepin dhe Fejzo Rexhepin, të cilët janë "Dëshmorë të Atdheut", por në luftë shkuan dhe babë e bir...

Babë e bir partizanë

Myrte Rexhepi lindi në fshatin e Lepenicë në vitin 1890. Nuk bëri shkollë, por mësoi nga jeta e madhe e familjes. Ai u martua me Merjemen dhe fëmija i parë, i quajtur Matan u lindi më 15 mars 1924. Ashtu si babai edhe i biri kur u rrit 9-10 vjeç, shkante pas bagëtisë në pllajata e Qyramengës, ku lodronte e ndiqte kafshët e egra e thëllëzat, duke bërë edhe gjueti. Në mbrëmje, prindrit dilnin te shtegu shtëpisë në Lepenicë, dhe prisnin të birin, ku nga larg dallohej që në brez mbante 3-4 thëllëza dhe në duar një lepur të egër. Shpesh babai edhe pse i ri e dërgonte te miqtë e familjes në Gumenicë, Brataj, Tërbaç, Ramicë, Velçë e Dukat, sepse ai dinte si t'i çante shtigjet për të çuar porositë e tij.

Vendi ishte pushtuar nga fashistët italianë. Në zonë filluan të ndiheshin gjëmimet e para të luftës. Një mbrëmje

të shkurtit 1942, nga Vlova, familjes së Rexhepajve, u erdhi një letër e dërguar nga Fejzo Rexhepi, në të cilën shkruhej: "Në këto kohë të vështira edhe unë vendosa me shokë të luftojmë me Nacionalçlirimtare, prandaj të keni kujdes për familjen, kalamaqërit,



MYRTE REXHEPI

mallin e gjënë, se ne do të luftojmë dhe fitojmë kundër kësaj kuçedre të Europës". Pastij u nis dhe Hano Rexhepi... Dalëngadalë në luftë u përshinë dhe babë e bir, Metan dhe Myrte Rexhepi. Bisedat midis tyre çdo mbrëmje ndizeshin kuvendimet, se si edhe ata duhej të kontribuonin në frontin e luftës

çlirimtare për lirinë e Atdheut. Gani Muhua në kujtimet e tij shkruan se "sapo shpërtheu Lufta e Dytë Botërore, në konakët e mi në Brataj, me Damë Xhelo, Kadri Brahimi dhe Laze Nuro Ferraj, "korrieri" që na sillte letra dhe "lajme" nga Hano Rexhepi dhe Neki Imeri ishte Myrte Rexhepi. Edhe pse ata u vendosën me banim në Mavrovë, dy-tri herë, mes rreziqeve e armikut, Myrte Rexhepi dhe Shamet Gjika na binin "kartat" e Arif Haskos dhe Qarkorit të Vlorës, për organizimin e Lëvizjes Antifashiste".

Në ato vite Myrte Rexhepi, u përfshi në betejat kundër nazifashistëve. Edhe pse ishte mbi 50 vjeç, ai u gjend së toku me fshatarët e tjerë në Luftën e Gjormit 1942-1943, përsëri me territorialet e Mavrovës, Vajzës, Kropishtit e Gumenicës, u gjend në luftën epepe të Drashovicës, shtator-tetor 1943. Në shënimet e tij historike, Murat Agaraj nga Kropishti vë në dukje se, së bashku me ne kropishtiotët në kodrat përballë Drashovicës, ishin edhe Alush Gjika, Myrte Rexhepi e Razip Sadiku, të cilët sipas urdhërimit të shtabit të luftës partizane kishin sjellë kuajt të ngarkuar me municione, që i kishin marrë te mulliri i Vajzës. Shtatori i atij viti shënoi rënien e fashizmit të Duçes, por ushtria italiane, ishte aty, në kazeramat e saj dhe në Sirokëmba ndodheshin depot e armatimit e municioneve. Një pushtues

tjetër me armë të rënda kishte shkelur truallin shqiptar, nazizmi gjerman. Myrte Rexhepi ishte pranë shtabit të Zonës së Parë Operative dhe kryente detyrën e korierit, por dhe të transportit me kafshë të mjaft materialeve dhe municioneve luftarake. Zëvendëskomandanti i ZIOp, Hasan Pulo e ngarkonte shpesh me detyra të korierit, por dhe të transportit të mallrave për shtabet partizane të zonës. Kështu ndodhi dhe në frontin e Drashovicës, në shtator të vitit 1943, ku u derdhën shqiptarë pa dallim feje e ideje, nga fshatrat, por edhe nga qyteti i Vlorës, nga Myzeqeja dhe Topalltia. Në mbrëmje, në pozicionet që i kishin zënë në kodra, shkoi dhe Mevlan Dervishaj, ushtarak, që u caktua komandanti i forcave të Shullërit, e që komandonte çetën partizane "Zigur Lelo" dhe çetat territoriale të Smokthinës dhe të Velçës. Partizanët Razip Sadiku dhe Myrte Rexhepi shërbyen si ndërlihdhësit e shtabit të ZIOp me komandantin në pozicionet e luftëtarëve popullorë.

Në ditët e para të prillit 1944, Refati i përcolli Matanin dhe Myrten deri te Vidhat e Petës, për në Sevaster, ku ishte përqëndruar shtabi partizan i Qarkut të Vlorës. Siç rrëfente më pas Matani, i biri për babanë Myrte, qëndroi disa kohë në shërbim të Shtabit të ZIOp, por dhe partizan Shtabit të Qarkut të Vlorës, më 20 maj 1944, në Sukë të Përmetit u rreshtua në radhët e Brigadës XII Sulmuese (BrXIIS). Përsëri në prapavijë të brigadës për transportim mallrash dhe municionesh.

Komunikim me radio me Shtabin e Përgjithshëm

BrXIIS duke bashkëvepruar veprimet edhe forcat territoriale, kreu sulme të vijueshme në asgjësimin e qendrave të fortifikuara të armikut, organizoi prita kundër autokolonave në rrugën Sarandë-Urë e Mifolit, si dhe gjatë rrugës Vlorë-Tepelenë. Këto forca goditën parreshtur garnizonet armike në kalanë e Borshit, në Spile të Himarës, në Vajzë etj., si dhe kontrollonin e godisnin lëvizjet në rrugët Borsh-Sarandë, Vajzë-Drashovicë-Mavrovë, etj., duke e detyruar armikun të tërhiqet në qendrat e tij të fortifikuara. Për plotësimin me sukses të detyrave ushtarake të BrXIIS në sektorin Vlorë-Kurvelesh dhe në mënyrë të veçantë në zonën bregdetare, shtabi i brigadës vepronte sipas detyrave të marra nga Shabi i Përgjithshëm. Në këtë periudhë ishte siguruar ndërlihdhje e rregullt me radio midis shtabit të brigadës dhe Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Nacionalçlirimtare, por përsëri ndërlihdhje me korrier dhe kafshë vazhdonte në formacionet dhe njësitë partizane. Në fund të korrikut 1944, forcat e batalionit katërt, së bashku me forcat territoriale, sulmuan garnizonin gjerman në Spile të Himarës, i cili ishte një nga garnizonet më të fortifikuara të armikut në zonën bregdetare. Pas sulmit e luftimeve u asgjësua garnizoni gjerman dhe zona nga fshati Borsh deri në fshatin Palasë u çlirua plotësisht. Në ditët e para të gushtit 1944 u çliruan fshatrat e Bregdetit nga Borshi deri në fshatin Nivicë-Bubar, duke e zgjeruar zonën e çliruar bregdetare Nivicë-Bubar deri në afërsi të Llogorasë, zonë ku forca partizane u vunë në roja vigjilente të kësaj pjese të bregdetit tonë. Në zbatim të urdhrave dhe të porositë të posaçme

të Komandantit të Përgjithshëm të Ushtrisë Nacionalçlirimtare, Enver Hoxha në fillim të tetorit 1944 forcat e BrXIIS, BrXIVS dhe BrXIXS kurorëzuan me sukses të plotë luftimet e ashpra që zhvilluan kundër garnizonit gjerman të fortifikuar e të rrethuar kudo me mina në zonën e qytetit të Sarandës duke e çliruar atë përgjithmonë. Forcat e BrXIIS u vunë menjëherë në roja vigjilente të të gjithë zonës bregdetare të çliruar deri në atë kohë nga Saranda gjer në fshatin Radhimë, afër qytetit të Vlorës. Pas çlirimit të qytetit të Sarandës, BrXIIS mori urdhrin për çlirimin sa më shpejt të qytetit të Vlorës. Shtabi i brigadës duke lënë në qytetin e lirë të Sarandës e të Himarës dhe në disa pika kryesore të bregdetit forcat e batalionit 4-t, që në atë kohë ishte rritur mjaft me partizanë të rinj, i dha urdhrë batalionit 1-rë të kalonte edhe ai në zonën e Drashovicës dhe së bashku me batalionet 3-4-ër organizuan goditje të vazhdueshme kundër garnizoneve naziste gjermane e forcave xhandaro-balliste që ishin struktur në disa pika të fortifikuara në afërsi të qytetit të Vlorës, si në Drashovicë, në Qafën e Koçiu, në Kaninë, në Ujin e Ftohtë e gjetkë duke i detyruar të tërhiqen me dëme në njerëz e materiale e duke i ndjekur këmbakëmbes deri në qytetin e Vlorës e tek Ura e Mifolit.

Kur batalioni i 1-rë i BrXIIS shkoi në Vajzë për çlirimin e Vlorës, pranë Mavrovës dhe në Drashovicë bëhej luftë me nazistët gjermanë. Myrtja ishte duke transportuar me kafshë municion, nga Vajza për në Mavrovë, kur më 6 tetor 1944, u godit nga një predhë e nazistëve dhe u dogj bashkë me mushkën.

Çudi, dëshmorë pa dëshmi

Me çlirimin e Shqipërisë nga pushtuesit fashist, Matan Rexhepi u kthye në Mavrovë, pranë familjes së tij. Aty dëgjoji se i ati, Myrte nuk ishte në shtëpi, pasi ai ishte vrarë nga predhat e artilerisë naziste, në Qafë të Mavrovës, në sulmet për çlirimin e Vlorës, u trishtua thellë. Ai rrëfente shpesh se si në sytë e tij, në betejat e aksionet kundër pushtuesve ishin vrarë shokët luftëtarë, dëshmorë të Atdheut. Matani i kujtonte shpesh ditët e rënies së tyre. Ai vendoste trëndafila në një kavanoz që qëndronte gjithmonë në dritaren e shtëpisë së tij në Mavrovë. Për kontributin e tyre në Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare, babë e bir u dekoruan me medaljet e "Trimërisë", të "Kujtimit" dhe të "Çlirimit".

Komandanti i BrXIIS Refat Barjami, në vitin 1954, bëri një vizitë në shtëpinë e luftëtarit të tij antifashist Matan Rexhepi, së bashku me antifashistin e shquar të Labërisë Bejto Isufi. Ai i ju theksoi se "Myrte ishte nga burrat luftëtarë të BrXIIS, plot zjarr e vrull në betejat, në Përmet, Këlcyrë, Sarandë, Himarë, kundër pushtuesve nazistë, në tetor 1944. Mbi të gjitha, ka qenë një luftëtar i guximshëm që u shpëtoi jetën sa e sa shokëve partizanë përballë armikut...", me sinjale të urdhrave të luftimeve, por dhe me furnizimin me municione dhe ushqime të luftëtarëve.

Në familje bëhej vizita si familje dëshmorë për vite me radhë, por dëshmi dëshmorë nuk pati në këto 80 vite nga dita e rënies. Këtë vit janë bërë dokumentat për t'u shpallur dëshmorë i Atdheut. Ishte kjo një pakujdesi dokumentacioni, një harresë nga veteranët, nga shokët partizanë të luftës, një mos interesim nga kuadrot e BrXIIS, nga pushtetit lokal dhe nga familja...gjithsesi ai është dëshmorë se ka dëshmuar me rënie e tij, por dhe dokumenti juridik duhet që t'u trasmentojmë brezave historinë e një luftëtarë që ra në vijën e luftës bashkë me mushkën, mjetin e transportit për lirinë e Atdheut.

ÇETA E KARBUNARIT-KOMANDANTI DHE ATA QË RANË DËSHMORË MË 1920




Nga: Xhevat Zenelaj

Shtabi, edhe pse Lufta I Botërore zyrtarisht mbaroi, duke pasur synime afatgjata për këtë perlë të Adriatikut Lindor, nuk u largua nga vendi ynë, por nguli kthetrat e saj imperialiste në shumë zona e pika strategjike të rajonit të jugut të vendit. Kjo i detyroi atdhetarët e vërtetë të ngrinin në këmbë gjithë popullin për të çliruar Vlorën dhe rrethinat e saj. Para Kuvendit të Barçallasë, patriotët morën takim thujse fshat më fshat për të organizuar e vënë në lëvizje energjitë njerëzore e materiale të çdo komuniteti në interes të luftës kundër asaj murtaje skllavëruese. Edhe në Karbunar, veç punës që bëri biri i këtij fshati, patrioti Ahmet Xhafaj dhe paria e fshatit, erdhi edhe vetë komandanti i ardhshëm i kësaj Epopeje, legendari Osman Haxhiu. S rezultat, brenda pak ditësh u krye organizimi i çetës së këtij fshati me 40 luftëtarë. Të rreshtuar në përbërje të saj ishin:

- 1.Sherif Ceno
- 2.Ago Birçe
- 3.Arif Haxhiu
- 4.Avdul Hasani
- 5.Azbi Selami
- 6.Brahim Hasani
- 7.Brahim Zotaj
- 8.Dule Zanaj
- 9.Dervish Mehmeti
- 10.Dino Myslymi
- 11.Faslli Fakaj
- 12.Gjysh Selimi
- 13.Hamit Danaj
- 14.Hasim Malko
- 15.Ismail Dervishaj
- 16.Kasëm Cenaj
- 17.Lelo Salua
- 18.Luto Dervishaj
- 19.Meço Banushi
- 20.Mehmet Selmani
- 21.Mersin Mehmeti
- 22.Mersin Xhafaj
- 23.Meto Kasaj
- 24.Muhamet Cenaj
- 25.Muharrem Hysenaj
- 26.Myrto Dervishaj
- 27.Nexhip Cano
- 28.Pasho Lamçe
- 29.Qamil Zenjelaj
- 30.Qatip Cenaj
- 31.Qazim Meçaj
- 32.Hysen Caushaj
- 33.Refat Bazaj
- 34.Sabri Veizaj
- 35.Selfo Xhelaj
- 36.Shefit Xhafaj
- 37.Shefit Selimi
- 38.Sheme Abedini
- 39.Telo Haxhiu
- 40.Veli Fakaj.

Komandant i saj u zgjodh i urti dhe trimi Sherif Cenaj



Sherif Cenaj



Shefit Xhafaj

(Figura 1). Po çfarë merite kishte ky që i besua nderi i çetës dhe jeta e luftëtarëve të saj? Sipas veprës së Prof. Bardhosh Gaçe "Vlora-Fjalor Enciklopedik", faqe 933-934, botim i vitit 2023, rezultojnë se: "Sherifi lindi në Karbunar të Vlorës në vitin 1882. Mbaroi Ruzhdien e Beratit më 1896. U përfshi në lëvizjen patriotike me ndikimin e Ahmet Durmishit dhe Ismail Qemalit, të cilin e mbështeti në votimet e vitit 1908. Mori pjesë në Kuvendin e Drashovicës dhe në kryengritjen anti-turke të vitit 1912 në Mallakastër. Luftoi kundër antartëve grekë në malet e Dhëmbllanit në 1913-1914. Ishte anëtar i shoqërisë "Bashkimi". Mori pjesë në Kuvendin e Barçallasë, 29 maj 1920. Me këto cilësi u zgjodh komandant i çetës së Karbunarit në Luftën e Vlorës 1920".

Me dhënien e kushtrimit, çeta nën komandën Sherifit, marshoi më 5 qershor dhe sulmoi postat italiane në Matohasanaj dhe në Sinanaj. Si u krye kjo detyrë, në përbërje të grupimit të çetave të Fëngut (komunës së Treblovës), bazuar në planin e shtabit të luftës mori detyrë dhe luftoi me trimëri në betejat kundër armikut në Risili, Sherishtë, Qafën e Koçiu, Gropën e Derrit, ullishtat e Vlorës e gjetkë.

Zëvendës komandant i kësaj çete ka qenë trimi Shefit Xhafaj (Figura 2). Po përse ky dhe jo ndonjë tjetër? Edhe këtë na e sqaron Prof. Gaça në veprën e mësipërme, fq. 928-929, nga ku citojmë: "Shefiti u lind në Karbunar më 12 shtator 1888. Me mbështetjen e Babë Dudës kreu shkollën plotore në Berat, babai dhe gjyshi të cilit ishin ndihmuar nga Xhafajt dekada më parë. U mor ushtar në Manastir dhe në Kozhan më 1905. Pas ushtrisë shërbeu si armëndreqës në garnizonin e Janinës në vitet 1906-1909. U përfshi në veprimtarinë klubit patriotik "Bashkimi" të Janinës, ku bashkëpunoi me patriotët Kadri Gjata, Namik Delvina, Ismail Lesko Progonati e Ibrahim Selimi. Për këtë veprimtari dhe si mbështetës i Ismail Qemalit, u pushua nga puna. Nën kujdesin e Isuf Bushit mësoi edhe shkrimin e gjuhës shqipe krahas asaj turke e greke. Në vitet 1911-1912 u përfshi në kryengritjen anti-turke të Mallakastrës e Tepelenës. Në vitet 1915-1919 punoi në minierën e serës në Selenicë, në shoqërinë SIMSA. Me krijimin e çetës së fshatit u zgjodh zëvendës komandant i saj".

Për ditët të tëra u sulmuan postet dhe pikëmbështetjet e fortifikuara italiane. Të gjithë, pa përjashtim luftuan me trimëri në betejën e Risilisë, Vreshtat e Mëdhë, Gropën e Derrit e gjetkë, ku Shefiti dha jetën në luftim e sipër. Të kthyerit nga ajo betejë thonë se: "Shefiti, Muhamet Cenaj e Ibrahim Zotua kishin avancuar aq pranë vijës së mbrojtjes italiane sa që dëgjoheshin edhe sharjet e mallkimet italisht të armikut.

Në luftim armiku përdori edhe artileri. Këta nuk po shihnin nga vinin plumbat, bombat e predhat e armikut, po iu hipi gjaku në kokë dhe i hidhnin armikut bombat njëra pas tjetrës, bile edhe disa granata të hedhura nga italianët arritën ti kapnin rrufeshëm dhe ia hidhnin prapë atij në llogore. Kjo "lojë" nuk vazhdoi gjatë se në një moment fatal, njëra prej tyre, apo predhë artilerie, plasi duke e copëtuar trupin e Shefitit, këtij trimi të çartur, në korrik 1920. Aty u plagosën edhe luftëtarët, Muhamet Ceno, të cilin, Ago Agaj, në librin e tij për këtë Epopeje e quan të vrarë. Po kështu u plagos edhe

Sabri Veizi, kurse fati i Mehmet Selman Zanajt nuk u mor vesh kurrë, sepse ai nuk u kthye me shokët dhe nuk u r më vesh për fatin e tij."

Ndërkohë, luftëtarë 24-vjeçar Ismail Serjan Dervishaj (1896-1920), në luftimet tek Kodrat e Risilisë, do ta jetësonte ndryshe aktin e tij heroik në këtë betejë të pabarabartë me pushtuesin. I maskuar si ushtar italian arrin të futet në pozicionet armike, merrte armë e municion e ua çonte shokëve të tij matanë llogoreve. Nuk dihet sa herë e kreu këtë veprim, diktohet dhe e gjuajnë nga aeroplani që miralonte pozicionet e tanëve. Një plumb i këputi këmbën dhe ai nuk lëviz dot më. U kap nga armiku e u syrgjynos në Leçe (Itali), ku për gati një shekull nuk u mor vesh asgjë për të. Por nipi i tij, Eqerem Dervishaj, e kishte peng në zemër fatin e këtij trimi të gjakut të tij, prandaj falë përpjekjes gati 10-vjeçare arriti ta argumentojë me dokumente e dëshmi edhe nga pala Italiane, aktin e tij vetëflijues. Me vendim nr. 49 dt. 17.3.2005 të Komisionit Shtetëror pranë Ministrisë Mbrotjtjes, Ismail Serjan Dervishaj u shpall Dëshmor i Atdheut. Eqeremi me plot pathos e dashuri u thuri vargje luftëtarëve të Çetës së Karbunarit dhe aktit të trimit Ismail Dervishaj:

Pas çlirimit të vendit, me Vendim të Këshillit të Ministrave të RPSH-së nr. 33 dt. 27.6.1974 Shefit Ibrahim Xhafaj u shpall Dëshmor i Atdheut. Mëmëdheu i çliruar i shpuri të rënët për liri në Varrezat e Dëshmorëve, ku prehen përjetësisht e të nderuar. Edhe në lapidarin përkujtimor të Dëshmorëve të fshatit tonë janë përjetësuar të 6 bijtë e komunitetit karbunaras që flijuan jetën për lirinë e vendit tonë. Lavdi e nderim të përjetshëm paçin DËSHMORËT E KOMBIT TONË.

"Seç u ngrënë e bënë benë,
S'e vunë kokën në kandar!
Komandant Sherif Cenaj,
me dyzet në vardhar...
N'Risili n'Grop të Derrit,
Seç mori plagë të rëndë.

Kaloi netët e ferrit:
Plumbi i preu një këmbë... (Ismailit)".

Më 3 shtator edhe luftëtarët karbunaras së bashku me luftëtarët të gjithë çetave nga Labëria e mbarë vendi festuan të lumtur e krenarë në Sheshin e Flamurit, fitoren e kësaj epopeje historike e të rrallë. Por trupin e trimit Shefit Xhafaj, regjimi zogist sa qe në fuqi e la atje ku ra, në Gropën e Derrit. Prandaj edhe populli me indinjatë kujton:

"Pa pyesni Telo Haxhinë,
Ku e pa Shefit Shefit Brahimnë?!,
Bomb e shkret i mori gjinë,
Nëpër flakë e nëpër tymë,
Gropës Derrit u vërvinë..."

Pas çlirimit të vendit, me Vendim të Këshillit të Ministrave të RPSH-së nr. 33 dt. 27.6.1974 Shefit Ibrahim Xhafaj u shpall Dëshmor i Atdheut. Mëmëdheu i çliruar i shpuri të rënët për liri në Varrezat e Dëshmorëve, ku prehen përjetësisht e të nderuar. Edhe në lapidarin përkujtimor të Dëshmorëve të fshatit tonë janë përjetësuar të 6 bijtë e komunitetit karbunaras që flijuan jetën për lirinë e vendit tonë. Lavdi e nderim të përjetshëm paçin DËSHMORËT E KOMBIT TONË.

Olimbi Dafa, rrëfen vetveten me vëllimin poetik “Fytyra e jetës”

Nga: Tomorr Kotorri

Olimbi Dafa, duket se penën nuk e heq nga dora asnjë moment dhe tani para lexuesit, prezantohet me vëllimin poetik “Fytyra e jetës”. Kur ecën në këmbë rrugëve të Tiranës, mes shoqeve në kafene, mes bisedave të shumta telefonike apo mes miqsh, në portrete krijuesish në gazeta, në lëvizje të ndryshme apo çaste meditimi në shtëpi, ajo mendon vetëm dhe vetëm të shkruaj. Tematika e krijimtarisë së saj është e larmishme, plot ndjenjë dhe perceptime që të sjellin çdo gjë afër sikur e ke përjetuar vetë atë çast, atë situatë, atë dialog, atë pamje, ngjarje, skenë...Ajo i gëzohet emrit gjyshe, i gëzohet nipit dhe mbesës që ja bënë jetën pranverë. Sa me ngjyra zemre përshkruan ajo portretin e vajzës së saj sikur të jetë një krijesë hyjnore. Pena e saj duket se është një vëzhguese e vëmendshme e gjithçkaje që ndodh në atdhe, që nga problemet sociale, politike, ekonomike, kulturore apo shoqërore. Stili saj ka një organizim të brendshëm që kërkon të zbërthejë delikaten, të panjohurën dhe enigmën. Harmonizimi poetik i vargjeve, vjen nga larmia e informacioneve që ajo merr në përditshmëri, pasi jetën nuk e shikon si një pemë për të marrë frytet, por si një pemë që e frymëzon, me lidhje të dyanëshme, i jep jetë dhe merr dritën e bukur poetike. Në këtë vëllim autorja vjen me një poezi më të ngjeshur në mendim, më të pjekur në ide, më të harmonizuar në mesazh dhe më të besueshëm në trajtimin jetësor. Mes dhjetëra poezive qysh në hyrje më bëri përshtypje poezia:

Nusja

*Që ku erdhi nusja,
na u prish terezia,
gjumi s'na zë natën,
na u prish qetësia.
Ule zërin nuse,
se na turpërove,
na dëgjojnë komshijet,
e na përgojove!....*

Një portretizim elegant i një problemi koherent. Problem që haset në të shumtën e çifteve të reja shqiptare. Një problem mbarë botëror që autorja e ka përshkruar me ngjyra humori. Nusët e reja janë të dëshiruara pas luksit, jetës pa stres, dëshirës për të shijuar gjithçka, por gjithmonë larg vjehrrave. Po nusët a kanë nëna?! Në përditshmërinë tonë shohim gra të veshura shik, me orë, bizhuteri, makina luksoze e cila kalon pa parë majtas apo djathtas, madje është aq e lumtur me madhështinë e saj fallco të floririt, sa nuk shikon as ndonjë lypës që mund ta shtyp me takat e saj të larta. Kjo është një kategori e vogël, por shumë e larguar nga realiteti, nga dhimbja, fukarallëku, hallet, problemet e shoqërisë. Ato e shikojnë vjehrrën me mospërfillje, e largojnë nga shtëpia, duan vetëm luks pa punë. Kjo kategori kulmin e kënaqësisë e shijon kur blen një çantë 300 dollarë, se sa të blejë apo lexojë një roman. Falsiteti kësaj kategorie grash është se ato as dinë të gatujnë, as të hekurosin, as të kujdesen për fëmijët. Realja është zhvendosur në hapësirën më të padukshme të gjithësisë. Me pak fjalë autorja ka bërë një vjershërim sintetik. “Një maskë në fytyrë s’e bën zonjë një grua”. Fjala grua është fjalë magjike. Grua do të thotë



nënë e mirë, do të thotë sakrificë, netë pa gjumë, punë për të siguruar të ardhmen e fëmijëve, do të thotë përkushtim, kursim, vizion, krenari pa luks të shfrenuar. Një nga nevojat tona bazë është të kuptohemi dhe të pranohemi nga njerëzit e tjerë, me thjeshtësinë tonë, me veshjen e thjeshtë por të bukur. Kërkesat e disa grave janë shumë, por realiteti është krejt tjetër, pasi në jetë jo çdo nevojë plotësohet, ndaj nuk duhet të ndihemi vetëm, në ankth, të depresuar, të shqetësuar, të braktisur dhe me ndjesi të tjera negative nëse nuk kemi luks apo mbushur trupin me sende të florinjta. O Zot, përse gratë qajnë aq lehtë? Zoti u përgjigj:

“Kur e krijova gruan m'u desh të ta krijoj të mbinatyrshme.

- Ia kam dhuruar supet aq të forta që ta mbajë peshën e botës dhe njëkohësisht, aq të buta që të krijojë rehati.

- Ia kam dhënë forcën e brendshme që të përballojë lindjen e fëmijës dhe mospranimin të cilin shumë herë e përjeton nga vetë fëmijët e saj.

- Ia kam dhënë forcën, e cila i ndihmon që gjithmonë të shkojë përpara edhe atëherë kur të gjithë të tjerët dorëzohen. Të kujdeset për familjen e saj edhe atëherë kur është e sëmurë dhe e lodhur, gjithnjë pa u ankuar. Kjo duhet të jetë grua ideale.

Emigrantit

*Në qarkullimin e gjakut të Atdheut të munguar,
jam unë emigranti i dëshpëruar,
që ëndrrat më ngelën pezull në emigrim,*



OLIMBI DAFJA

Pena e saj duket se është një vëzhguese e vëmendshme e gjithçkaje që ndodh në atdhe, që nga problemet sociale, politike, ekonomike, kulturore apo shoqërore. Stili saj ka një organizim të brendshëm që kërkon të zbërthejë delikaten, të panjohurën dhe enigmën. Harmonizimi poetik i vargjeve, vjen nga larmia e informacioneve që ajo merr në përditshmëri, pasi jetën nuk e shikon si një pemë për të marrë frytet, por si një pemë që e frymëzon, me lidhje të dyanëshme, i jep jetë dhe merr dritën e bukur poetike.

*dielli që s'më ngroh në dhe të huaj,
ja shton vlerat, shpirtit të Atdheut tim!
S'më zë gjumi çdo natë s'më zë,
për rrënjët që i braktisa dhe lashë në Atdhe,
dhe asnjëherë se bëj gjumin të qetë,
se në vesh më vjen një zë i fuqishëm,
që është zëri i Atdheut që më thërret.
Një poezi tepër e veçantë që më rrëmbeu.
Jam pjesë e kësaj poezie pasi kam qenë 7 vjet në emigrim...*

Kufijtë e Evropës janë të mbushur me varre emigrantësh dhe refugjatësh të paidentifikuar, duke i lënë familjet e tyre të kërkojnë, shpesh më kot, për të vërtetën e asaj që ndodhi, kur dhe ku. Emigrantët, turmë e dhimbshme njerëzore, që humbet

jetën rrugëve, gjatë migrimit, ose që mbijeton pa iu njohur dinjiteti e as të drejtat.

“Sa vëllezër dhe motra sot ndodhen në të njëjtën gjendje, si shtegtari i shëmbëlltyrës? Shumë! Sa janë grabitur, zhveshur, rrahur gjatë rrugës? Largohen të mashtruar nga trafikantët e paskrupullt. Më pas shiten si mall tregu, kapen, burgosen, shfrytëzohen, robërohen. Poshtërohen, torturohen, dhunohen. E shumë e shumë vdesin pa arritur kurrë qëllimin e tyre. Rrugët e migrimit të kohës sonë janë të populluara nga burra e gra të plagosur e të braktisur gjysmë të vdekur, nga vëllezër e motra, britma e të cilëve arrin deri tek Zoti. Shpesh janë njerëz të ikur nga lufta dhe terrorizmi, siç e shohim fatkeqësisht në ditët e sotme”, - ka theksuar Papa në një çast lutjeje në Sheshin e Shën Pjetrit. Por është dhe një realitet tjetër...

Por nëse do flasim për letërsinë, emigracioni ka dhe një anë tjetër. Një anë pozitive. Emigracioni solli dhe krijimin e një elite me aftësi të veçanta në art, sport, letërsi e shumë sfera të tjera. Një pjesë e mirë emigrantësh shqiptarësh arritën të individualizohen në sfera të artit apo dhe fushave të tjera, duke u kthyer në ambasadorë të Paqes dhe mirëkuptimit të vendeve me njëri tjetrin dhe duke krijuar një imazh të ndryshëm për emigracionin shqiptar. Shumë krijues emigrant kanë lartësuar emrin e Shqipërisë në botë. Nuk thuhet më kotë, letërsia e bukur vjen nga dhimbje të mëdha...Poetika e Olimbisë në këtë vëllim është e pasuruar me gjetje tematike të larmishme, me fabula jetësore të befasishme të cilat i ka shkruar në vargje poetike plot finesë. Poezitë në këtë vëllim japin një ngjyrim emocional në rritje nga poezia në poezi, sepse autorja duke qenë kryepersonazhe e situatave të vargjeve poetike ka derdhur mbi to nektarin më të ëmbël të fjalorit të pasur shqiptar. Autorja, ka një stil të vizatur thjeshtë, por që i ngjan një pikturë delikate që nga çasti në mund të të verbojë nga shkëlqimi i harmonisë estetike. Duke qenë vetvetja, me stilin e vet të singertë autorja në të gjitha poezitë ka një fjalor të pasur, një gërshetim të poezisë me filozofinë, një harmonizim të tematikës me gjetjet artistike të poezisë, një tendencë për të qenë transparente në vargëzim por edhe me nëntekst, kur e vërteta poetike trillohet për të tërhequr lexuesin. Në mjaft poezi poetja duket se dialogon me veten që mund të duket si një prozë, por në të vërtetë është një mjeshtëri artistike e poetes që edhe një tog fjalësh proze e zbukron mjeshtërisht poetikisht. Duke parë tematikën në tërësi në libër lexohet qartazi se autorja është gjurmuese e së veçantës, inspirueses, intriguases por edhe e së bukurës. Hyrja e poezisë në histori bëhet në mënyrë të sintetizuar duke treguar dijet e saj por edhe dëshirën për të sjellë realitete atdhetare që e bëjnë poezinë shumë transparente dhe mesazhsjellëse.

Të gjitha poezitë e librit kanë unitet në linjën artistike, lartësimin e figurative poetike që formatojnë një poezi sa koherente dhe moderrne, po aq klasike dhe lirike. Një harmonizim i dyanshëm që nuk trillon por vërteton madhështinë e vargut që del nga zemra.

